



# RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË  
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**  
për vitin 2014



# **RAPORT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË për vitin 2014**

Tiranë, 2015



## PËRMBAJTJA

Hyrje .....	4
Kapitulli 1. Veprimtaria ligjvënëse .....	5
Kapitulli 2. Kontrolli parlamentar .....	12
Kapitulli 3. Funksioni zgjedhës .....	20
Kapitulli 4. Veprimtaritë ndërkombëtare .....	22
Kapitulli 5. Transparenca parlamentare .....	33
Kapitulli 6. Shërbimi administrativ .....	41
Kapitulli 9. Plani i Veprimit për vitin 2015 .....	51



## Hyrje

Funksionimi i Kuvendit është përmirësuar në të gjithë treguesit e performancës së tij, duke ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit European për Shqipërinë, kryesisht në drejtim të miratimit të ligjeve të nevojshme për plotësimin e 5 prioritetëve të rekomanduara nga Komisioni European për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në, forcimin e kontrollit politik mbi qeverinë, përmirësimin e rolit të Kuvendit në procesin e integritetit, rritjen e transparencës në procesin ligjvënës dhe të bashkëpunimit me shoqërinë civile, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të institucionit.

Vetëm gjatë vitit të fundit Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar 246 akte parlamentare (145 ligje, 83 vendime dhe 18 rezoluta). Është miratuar reforma administrative-territoriale si dhe një sërë ligjesh të tjera të rëndësishme që kërkonin shumicë të cilësuar, të cilat reflektojnë impulsin dhe angazhimin e lartë për reforma të rëndësishme. Gjithashtu është rritur efikasiteti i kontrollit parlamentar mbi ekzekutivin, kontrolli dhe ndërveprimi me institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, si dhe është përmirësuar transparenca në procesin legjislativ dhe aksesin e informimit të publikut lidhur me këtë proces dhe me veprimtari të tjera parlamentare.

Këto janë vetëm disa prej të dhënave të pasqyruara në raportin vjetor për vitin 2014 të veprimtarisë së Kuvendit, i cili synon të japë një panoramë analitike të punës së kryer gjatë kësaj periudhe përmes 9 kapitujve përbërës të hartuar nga shërbimet e Kuvendit të Shqipërisë sipas specifikave dhe fushës që ata mbulojnë. Hartuesit e këtij raporti e kanë gjykuar me vend ta vënë theksin e raportimit në kapitullin e fundit mbi objektivat dhe prioritetet për vitin 2015 në funksion të prezantimit sa më qartë të vizionit për të ardhmen e funksionimit të shërbimeve të Kuvendit, në përputhje me vizionin dhe politikën e drejtuesve të tij.


## Kapitulli 1

### VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE

Kuvendi është organi më i lartë ligjvënës, është institucioni ku zhvillohet dialogu politik ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin e reformave të kërkuara dhe përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në kuadër të procesit të integritit evropian të Shqipërisë.

Viti 2014 për Kuvendin ishte një vit me rëndësi të veçantë, për faktin se Shqipëria ndodhej në prag të marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE. Ky fakt rriti angazhimin për realizimin e reformave të kërkuara nga BE-ja.

Në këto kushte, Kuvendi gjatë vitit 2014 ka intensifikuar veprimtarinë ligjvënëse, duke shqyrtuar e miratuar ligje për realizimin e reformave të rëndësishme në dobi të zhvillimit të vendit. Ka ushtruar funksionin e kontrollit parlamentar, ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit Shqipëri–BE nëpërmjet instrumenteve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.



Gjatë vitit 2014 Kuvendi i Shqipërisë përmes dy sesioneve parlamentare, fokusuar në 43 seanca plenare publike e në një shtrirje kohore prej 216 orësh, ka zhvilluar një aktivitet të gjerë parlamentar. Veprimtaria legjislative është bërë motori i procesit të konsolidimit të institucioneve të shtetit dhe integritit evropian. Kuvendi i Shqipërisë, si institucioni më i rëndësishëm i zhvillimit të jetës politike në vend, ka përmbushur një nga detyrat më të rëndësishme në drejtimin politik të shtetit: miratimin e ligjeve. Kuvendi

në seancë plenare, si aktiviteti kryesor parlamentar, ka miratuar 316 akte, nga këto 184 ligje, 114 vendime dhe 18 rezoluta; janë zhvilluar 1075 diskutime (701 shumica dhe 374 pakica) në 216 orë debat parlamentar, ku janë ftuar të bashkëpunojnë të gjithë deputetët dhe nëpërmjet tyre i gjithë vendi.


Funksioni legjislativ ka konsistuar në miratimin e 184 ligjeve. Miratimi i kuadrit ligjor është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe vjen në harmonizim me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe atë të Bashkimit Evropian. 92% e nismave legjislative kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave, ndërsa 8% nisma të deputetëve, përqindje kjo më e lartë në krahasim me vitet e mëparshme. E përkthyer në shifra, në 184 ligje të miratuara 14 prej tyre kanë qenë nisma deputetësh dhe 170 nisma të Këshillit të Ministrave.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke e njohur dhe sanksionuar përqendrimin e pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë, ka lejuar si raste përjashtimore nxjerrjen e akteve me



fuqinë e ligjit edhe nga Këshilli i Ministrave. Kjo kushtëzohet me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës. Në këtë këndvështrim të veprimtarisë legislative Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar dy akte të tilla. Përdorimin e këtij instrumenti ligjvënës nga ana e ekzekutivit legjislativi e ka vlerësuar në përputhje me kushtet e parashikuara nga Kushtetuta, duke mos cenuar aspak pavarësinë e këtij të fundit dhe karakterin demokratik të shtetit.

Ligjet e miratuara në seancë plenare kanë ardhur si rezultat i punës së zhvilluar në komisionet parlamentare, pasi pikërisht prej këtu deputetët, të bashkuar në një rreth më të ngushtë sipas fushave të përgjegjësisë që mbulojnë, i kanë shqyrtuar ato, diskutuar dhe më pas ia kanë referuar seancës plenare. Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar dhe miratuar 314 projektakte ligjore, konkretisht: 122 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, ose propozimin e nismave të reja ligjore, 60 marrëveshje ndërkombëtare, 18 projektrezoluta dhe 114 projektvendime. E gjithë veprimtaria parlamentare në komisionet e përhershme dhe nënkomisione është realizuar me organizimin e 608 mbledhjeve, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 734 orë e 30 minuta.




Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve ka qenë edhe organizimi i 238 seancave dëgjimore: 116 për procesin legjislativ, 38 për procesin zgjedhës dhe 63 për kontrollin parlamentar. 21 seanca dëgjimore janë zhvilluar me grupet e interesit me kërkesën e këtyre të fundit.

Në përfundim të shqyrtimit të nismave ligjore komisionet e përhershme kanë miratuar 2347 amendamente, të cilat ia kanë paraqitur për shqyrtim dhe miratim seancës plenare.



## NUMRI I SEANCAVE DËGJIMORE



### *Reformat ligjore sipas komisioneve të përhershme*

#### **Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

Duke pasur në fokus të veçantë konstatimet, problematikat dhe rekomandimet e adresuara në raportet e progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë ndër vite, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut gjatë vitit 2014 ka bashkëvepruar dhe koordinuar veprimtarinë e tij parlamentare, ndër të tjera, me institucionet e ekzekutivit, institucionet e drejtësisë, institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe vendase që asistojnë vendin në procese të rëndësishme reformuese, me ekspertë të fushës dhe grupe të ndryshme interesi.

Veprimtaria e këtij Komisioni gjatë vitit 2014 ka përfshirë shqyrtimin e projektligjeve në fushat nga më të rëndësishmet. Në fushën e gjyqësorit dhe të drejtësisë kanë kaluar shtesa dhe ndryshime për funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë etj. Në fushën e të drejtave të njeriut kemi shtesa dhe ndryshime sa i përket medieve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, për partitë politike etj. Fusha të tjera që prekin këto nisma janë ato të qeverisjes vendore, të administratës publike, duke përfshirë gjithashtu dhe një sërë ndryshimesh në disa kode kryesore që funksionojnë në Republikën e Shqipërisë.

#### **Komisioni për Integrimin Europian**

Komisioni për Integrimin Europian ka shqyrtuar një sërë projektligjesh që janë detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) dhe të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrim.

Në lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin europian si detyrim i marrëdhënies kontraktuale me Bashkimin Europian (BE), duhet theksuar se ky proces ka shënuar një rritje, duke marrë parasysh se ky Komision ka shqyrtuar si tekste bazë që rregullojnë një fushë të caktuar, si ndryshime dhe shtesa në ligje të tjera për të rritur përafrimin e legjislacionit.



Për sa i përket përparësive të caktuara nga Komisioni European në raportet e progresit Komisioni ka shqyrtuar ato projektligje që i përkasin reformës në drejtësi, në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit.

### **Komisioni për Politikën e Jashtme**

Gjatë vitit 2014 Komisioni ka marrë në shqyrtim ratifikimin e një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare dhe projektligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

### **Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Gjatë vitit 2014 Komisioni ka shqyrtuar shumë nisma, të cilat prekin fusha të ndryshme. Ndër to më të rëndësishmet janë: 1) buxheti i shtetit për vitin 2015 dhe paketa fiskale që e shoqëron atë; 2) financat publike, ku janë ratifikuar një sërë marrëveshjesh të rëndësishme për huamarrjen shtetërore, por dhe kanë kaluar projektligji “Për sigurimin e depozitave” dhe projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9572, datë 3.07.2006, «Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare»”; 3) për përmirësimin e klimës së biznesit përmes projektligjit “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe projektligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” etj.; 4) për sigurinë energjetike; 5) për reformën e pensioneve etj.

### **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**

Rëndësi të veçantë i është kushtuar paketës ligjore për reformën në Forcat e Armatosura, ku përfshihet karriera ushtarake në FA, autoritetet dhe pushtetet e drejtimit e të komandimit të tyre, si dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Po ashtu një rëndësi të veçantë i është kushtuar miratimit pas shumë kohësh të *Dokumentit të Sigurisë Kombëtare*, dokument që sjell një sërë risish në konceptin më të ri sipas standardeve të kërkuara për një vend anëtar të NATO-s.

### **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin**

Gjatë vitit 2014 Komisioni ka shqyrtuar shumë nisma, të cilat prekin fusha të ndryshme. Ndër më të rëndësishmet i përkasin sektorit minerar në Republikën e Shqipërisë, përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, prodhimit, transportimit dhe tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme për transport etj., si dhe ratifikimin e një sërë marrëveshjesh të tjera të rëndësishme në fushën e industrisë dhe të energjetikës.

Në fushën e bujqësisë janë shqyrtuar projektligje për mbrojtjen e tokës bujqësore, për vlefshmërinë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore etj., si dhe janë ratifikuar një sërë marrëveshjesh të rëndësishme.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit vlen të përmendet shpallja e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në fushën e transportit ndryshimet në Kodin e Republikës së Shqipërisë.

### **Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë**

Gjatë vitit 2014 Komisioni ka shqyrtuar shumë nisma, të cilat prekin fusha të ndryshme. Në fushën e çështjeve sociale dhe të shëndetësisë janë sjellë ndryshime në ligjin për sigurimet shoqërore, për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë etj. Vend të rëndësishëm në veprimtarinë e këtij





Komisioni zë dhe fusha e aftësisë së kufizuar përmes projektligjit “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Në fushën e shëndetësisë projektligjet e shqyrtuara i përkasin shërbimit të urgjencës mjekësore, kujdesit paliativ, pajisjeve mjekësore, barnave dhe shërbimit farmaceutik si dhe çështjeve që kanë të bëjnë me Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë dhe Urdhrit të Stomatologut.

### **Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik**

Reforma në fushën e arsimit dhe të kulturës ka zënë vendin e duhur në veprimtarinë e këtij Komisioni. Ndryshimet kanë konsistuar në arsimin profesional dhe në arsimin e lartë. Janë bërë amendime në legjislacion për Universitetin e Mjekësisë në bashkëpunim me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në këtë fushë projektligjet më të rëndësishme që janë shqyrtuar kanë sjellë ndryshime dhe shtesa në ligjin për arsimin e lartë dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër janë ratifikuar marrëveshje të rëndësishme për pjesëmarrjen e vendit tonë në programet “Erasmus” dhe në programin kuadër “Horizon 2020”.

### **Dekrete për rishqyrtim ligji**

Gjatë këtij viti Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend 8 prej ligjeve të miratuara. Në të gjitha rastet Kuvendi ka rrëzuar veton presidenciale, çka e ka shtyrë opozitën që në disa raste të bëjë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Ligjet e kthyera për rishqyrtim janë:

- Ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- Ligji nr. 101/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, «Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë», i ndryshuar”.
- Ligji nr. 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 «Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative»”.
- Ligji nr. 97/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996, «Për Shkollën e Magjistraturës», i ndryshuar”.

### **Komisione të posaçme**

Në zbatim të programit të punës për realizimin e reformave të mëdha, Kuvendi gjatë vitit 2014 ka ngritur 2 komisione të posaçme.

- Me vendimin nr. 1/2014, datë 20.01.2014, Kuvendi ngriti Komisionin për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë, me objekt përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë, hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrative-territoriale dhe përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

Veprimtaria e këtij komisioni zgjati 6 muaj, në përfundim të së cilës Kuvendi në seancë plenare



miratoi produktin e këtij Komisioni: projektligjin “Për ndarjen administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, projektligj i cili u ankimua nga opozita në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit vendosi rrëzimin e kërkesës së paraqitur për antikushtetutshmëri të ligjit.

- Me vendimin nr. 96/2014, datë 4.12.2014, Kuvendi ngriti Komisionin për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Komisioni i posaçëm parlamentar ka për objekt të veprimtarisë së tij analizimin e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe diskutimin gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjektet e tjera të interesuara dhe opinionin publik; hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe propozimin për miratimin e një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, të subjekteve të tjera të interesuara dhe të opinionit publik. Opozita parlamentare ka bojkotuar deri më sot pjesëmarrjen në këtë komision.

### ***Në drejtim të organizimit dhe funksionimit të Kuvendit***

Gjatë vitit 2014 akti bazë mbi të cilën organizohet dhe funksionon Kuvendi, Rregullorja, pësoi ndryshime. Ndryshimet kanë të bëjnë me anëtarësinë e deputetëve vetëm në një komision të përhershëm parlamentar, si dhe marrjen e fjalës nga përfaqësuesi i opozitës menjëherë pas fjalës së Kryeministrit me të njëjtin minutazh. Anëtarësia në një komision të përhershëm është shoqëruar me ndryshime në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit, çka ka sjellë përmirësime në drejtim të organizimit dhe funksionimit të tyre.

### ***Në mbështetje të veprimtarisë parlamentare të Kuvendit***

Në mbështetje të veprimtarisë parlamentare të Kuvendit funksionojnë ***Shërbimi Juridik dhe Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit (SHPL)***.

Gjatë vitit 2014 SHPL-ja ka mbështetur në mënyrë efektive Kuvendin me ekspertizë juridike të një standardi të lartë në çështjet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian përmes hartimit të opinioneve ligjore dhe relacioneve për 43 projektligje që i janë propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Për 16 projektligjet që synonin përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian SHPL-ja ka hartuar opinion ligjor, kurse për 27 projektligje të tjera, që nuk synonin përafrim me *acquis* të BE-së, por që janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni për Integrimin Europian (KIE), ka hartuar relacion. Gjatë vitit 2014 SHPL-ja ka analizuar përputhshmërinë me *acquis* të BE-së për 18 ligje më shumë se në vitin 2013 (25 projektligje), duke paraqitur 4 opinione ligjore dhe 14 relacione më shumë se në vitin 2013 (12 opinione dhe 13 relacione).

Në opinionet ligjore që SHPL-ja ka hartuar për 16 projektligjet që synonin përafrimin me *acquis* të BE-së, janë paraqitur 137 sugjerime për amendamente, të cilat kanë konsistuar në përmirësimin e formulimeve dhe të përcaktimeve të projektligjeve, me qëllim përafrimin e tyre të plotë me *acquis* e BE-së. KIE gjatë shqyrtimit dhe miratimit të këtyre projektligjeve ka pranuar dhe miratuar 120 (87.59%) nga 137 sugjerimet e paraqitura.

Referuar numrit të sugjerimeve të paraqitura dhe të pranuar, si dhe mesatares së sugjerimeve të paraqitura dhe të pranuar për një projektligj gjatë një viti kalendarik, si matës sasior të performancës, rezulton se performanca e SHPL-së gjatë vitit 2014 është përmirësuar krahasuar me vitin 2013 në të katër treguesit. Gjatë vitit 2014 janë paraqitur 61 sugjerime më shumë dhe janë pranuar 50 sugjerime më shumë se në vitin 2013 (paraqitur 76 sugjerime pranuar 70). Gjithashtu edhe mesatarja e sugjerimeve



të paraqitura dhe të pranuar për një projektligj është rritur, respektivisht nga 6.33 që ishte në vitin 2013 në 8.56 në vitin 2014 (ose mesatarisht 2.23 sugjerime më shumë) dhe nga 5.83 që ishte në vitin 2013 në 7.5 në vitin 2014 (ose mesatarisht 1.67 sugjerime më shumë). Kurse në terma relativë përqindja e pranueshmërisë së sugjerimeve nga KIE është reduktuar nga 92.10% që ishte në vitin 2013 në 87.59 % në vitin 2014, ose 4.51% më pak.

Gjatë vitit 2014 SHPL-ja ka bashkërenduar punën me shërbimet e tjera të Kuvendit për përgatitjen e raporteve ose informacioneve të Kuvendit në kuadër të procesit të integritit evropian të Shqipërisë dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe SHPL-ja ka hartuar 9 raporte/ informacione të Kuvendit.

Në mbështetje të veprimtarisë parlamentare funksionon edhe *Shërbimi Juridik*, i cili e ka zhvilluar aktivitetin e vet në bazë të rolit dhe të funksioneve të Kuvendit, si pjesë e sistemit të përgjithshëm institucional dhe nevojave specifike të shprehura nga organet parlamentare. Organizimi dhe drejtimi i tij funksional e fleksibël është orientuar në zbatimin e programeve dhe objektivave të administratës së Kuvendit dhe është bazuar në metodat e punës së integritit sistematik të aktiviteteve të strukturave të tjera të kësaj administrate.

Gjatë vitit 2014 këshilltarët-juristë në komisione kanë përgatitur 220 memo për projektligjet, marrëveshjet ndërkombëtare, projektvendimet dhe projektrezolutat e shqyrtuara në komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e ngritura pranë tyre. Rreth 80% e amendamenteve të propozuara në opinionet ligjore (memot) e këshilltarëve-juristë për projektligjet janë paraqitur edhe në raportet e komisioneve të përhershme. Këshilltarët-juristë kanë përgatitur 5 memo për ligjshmërinë e ngritjes së komisioneve hetimore drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe 7 memo në kuadër të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për deputetët.

Këshilltarët e Shërbimit Juridik kanë intensifikuar bashkëpunimin me deputetët-anëtarë të komisioneve të përhershme për përgatitjen e relacioneve të tyre në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të ngritjes së çështjeve problematike parimore apo të përmbajtjes nen për nen të projektligjit.

Gjatë vitit 2014 Shërbimi Juridik ka përgatitur materiale mbrojtëse – shpjegime dhe prapësime si dhe përfaqësim (në datat kur janë zhvilluar seancat gjyqësore) të Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese për 11 çështje, ndër to dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës midis Presidentit dhe Kuvendit për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Me autorizim të Sekretares së Përgjithshme këshilltarët e Shërbimit Juridik gjatë vitit 2014 kanë përgatitur prapësime, shpjegime përfundimtare, provat, ankimimet dhe rekursat për 17 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë; 13 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë; 13 çështje në Gjykatën e Lartë.



## Kapitulli 2

# KONTROLI PARLAMENTAR


Veprimtaria e legjislativit është shtrirë edhe në rritjen e transparencës dhe të ushtrimit të kontrollit parlamentar, si funksion tjetër kushtetues i tij. Kuvendi, si institucioni më i lartë ligjvënës, ka ushtruar kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin, por edhe mbi organe kushtetuese dhe të krijuara me ligj nga ai vetë për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Këtë kontroll Kuvendi e ka ushtruar nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë e në Rregulloren e Kuvendit. Në këtë këndvështrim, këto instrumente kanë synuar ta bëjnë qeverinë të paraqesë raporte dhe të flasë nëpërmjet rolit të lartë drejtues të saj, e kanë detyruar atë të japë argumente për atë që ka bërë, duke krijuar mundësinë e një debati për informacionin e paraqitur. Në kuadër të kompetencave të kontrollit vlejné të theksohet kontrolli që Kuvendi ka ushtruar mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve të tilla ligjore bashkëkohore si: seancat e pyetjeve, interpelancat, mocionet mbi çështje të zbatimit të politikës nga qeveria, çështje të zbatimit të ligjeve dhe qëndrimet e saj mbi çështje të ndryshme etj.

*Kontrolli parlamentar në seancë plenare paraqitet si vijon:*

### Interpelancat

Interpelancat, si instrumenti kryesor i ushtrimit të kontrollit ndaj qeverisë, është kërkuar kryesisht nga mazhoranca parlamentare dhe në pak raste nga opozita. Gjithsej janë 11 interpelanca të kërkuara dhe të zhvilluara, dy prej të cilave janë zhvilluar me Kryeministrin, zotin Edi Rama, për çështje të sigurisë publike dhe lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri dhe politikat e qeverisë në

kuadër të proceseve të integritimit. Nëntë interpelancat e tjera janë zhvilluar me anëtarë të tjerë të qeverisë për çështje të rëndësishme të veprimtarisë së saj gjatë vitit 2014, si: për masat e marra nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për çështjen e mungesës së teksteve shkollore në gjuhën amtare për shkollat e minoritetit; për masat e parashikuara për problemet e organizimit dhe administrimit të Maturës Shtetërore 2014; për ndërprerjet e shpeshta të energjisë në zonat rurale, qarku Gjirokastrë; faturimet aforfe, mbifaturimet dhe mungesa e investimeve në këtë sektor; gjendjen aktuale dhe strategjinë e trajtimit të mbeturinave urbane në vendin tonë; për ecurinë e investimeve për sigurinë dhe sinjalistikën rrugore gjatë vitit 2014 në kuadër të masave për parandalimin e aksidenteve rrugore dhe ecurinë e investimeve në akset e aksidenteve rrugore; për respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri





dhe politikat e qeverisë në kuadër të proceseve të integritetit etj.

## **Pyetjet**

Pyetjet, si një tjetër instrument i ushtrimit të kontrollit parlamentar, kanë qenë shumë dominuese në krahasim me mekanizmat e tjerë. Në të shumtën e rasteve ato janë ushtruar me shkrim (66 gjithsej), ku kryesisht është kërkuar nga opozita parlamentare, me objekt marrje informacioni për veprimtarinë e Këshillit të Ministrave apo të institucioneve të ndryshme. Informacioni i kërkuar ka qenë lidhur me çështje të ndryshme e të një spektri mjaft të gjerë problematikash, ndër to: për menaxhimin e burimeve njerëzore, për zbatimin e paketës për biznesin fason dhe treguesit krahasimorë për ecurinë e biznesit fason në vitin 2014, për botimin në “Fletoren zyrtare” të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për prokurimet publike, për hartimin e projektligjit “Për kujdesin shëndetësor të punonjësve të Policisë, për importin e barnave të paregjistruara, për dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve, për funksionimin e arsimit profesional, për fëmijët e ngjuar, për procedurat e konkurrimit për emërimet e bëra, për arsimin profesional, për numrin e nxënësve romë dhe egjiptianë të regjistruar në klasën e 10-të të arsimit profesional, për mënyrën e përdorimit të fondit të nxitjes së punësimit etj.

## **Mocion për debat**

Me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendi më 15.05.2014, duke ndryshuar rendin e ditës të seancës plenare, zhvilloi një mocion për debat lidhur me ngjarjen e ndodhur në Divjakë, ku u rrëzua një helikopter që transportonte lëndë narkotike. Për këtë ngjarje u debatua për 2 orë rresht, ku opozita akuzoi Forcat e Armatosura për implikim në përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët. Përfundimi i debatit nuk u shoqërua me projektdeklaratë apo projektrezolutë.

## **Raportimet**

Në kuadër të kontrollit ndaj disa organeve kushtetuese dhe të krijuara me ligj Konferenca e Kryetarëve, bazuar në nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, në fillim të vitit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit vendosi për grafikun e raportimeve në Kuvend. Raportimet e këtyre institucioneve për veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2013 u zhvilluan në komisionet e përhershme parlamentare. Kuvendi u shpreh me instrumentin e rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Avokati Popullit; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Enti Rregullator i Energjisë Elektrike; Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive; Autoriteti i Konkurrencës; Banka e Shqipërisë; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Autoriteti i Medieve Audiovizive; Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar; Prokuroria e Përgjithshme; Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Agjencia e Sigurimit të Depozitave; Departamenti i Administratës Publike.

Duhet theksuar se nga organet e mësipërme është respektuar data e depozitimit në Kuvend të raporteve, si dhe mbrojtja nga ana e titullarëve të tyre në komisionet e përhershme gjatë zhvillimit të debateve dhe vlerësimit të punës së tyre. Gjatë vitit 2013 Kuvendi ka vlerësuar veprimtarinë e këtyre institucioneve nëpërmjet miratimit të 16 rezolutave.

## **Komisionet hetimore**

Gjatë vitit 2014 Kuvendi ka ngritur gjashtë komisione hetimore, ndërkohë që në vitin 2013 është ngritur vetëm një komision hetimor. Me vendimin nr. 8/2014, datë 6.02.2014, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike u ngrit komisioni hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit



në fuqi gjatë procesit të lëvizjeve në burimet njerëzore të Policisë së Shtetit. Objekti i punës së këtij komisioni ishte hetimi rreth veprimtarisë së institucioneve shtetërore sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe veçanërisht në ligjin për Policinë e Shtetit për zbatimin e tij në procesin e lirimt dhe lëvizjeve në Polici. Në përfundim të hetimeve komisioni hetimor paraqiti në seancë plenare dy raporte me qëndrime të ndryshme. Raporti i miratuar nga mazhoranca parlamentare u dërgua edhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Me vendimin nr. 26/2014, datë 22.04.2014, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste Kuvendi ngriti komisionin hetimor për hetimin e akuzave mbi implikimin e Forcave të Armatosura dhe bazave ushtarake në veprimtari të kundërligjshme: transportimin e lëndëve narkotike. Objekti i hetimit të këtij komisioni ishte hetimi në institucionet dhe bazat e ushtrisë, veçanërisht në aerodromet dhe pika të tjera të rëndësishme ushtarake ku pretendohet se ishin grumbulluar dhe transportuar lëndë narkotike. Opozita parlamentare e bojkotoi pjesëmarrjen në komision, megjithëse kishte ngritur mjaft probleme e dyshime. Komisioni e realizoi hetimin brenda afatit njëmuor dhe paraqiti në seancë plenare raportin me konkluzionet përkatëse, i cili u miratua vetëm me votat e mazhorancës.

Me vendimin nr. 40/2014, datë 12.06.2014, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike Kuvendi miratoi ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike dhe shoqëritë tregtare shtetërore. Objekti i këtij hetimi ishte kontrolli dhe hetimi në institucionet shtetërore për zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në lëvizjet dhe largimet nga puna të disa punonjësve. Veprimtaria e komisionit u bojkotua nga opozita parlamentare. Për pasojë, në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”, komisioni pushoi së ekzistuari.

Me vendimin nr. 70/2014, datë 25.09.2014, me propozim të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut Kuvendi miratoi ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulëzim Lelçaj. Opozita parlamentare e bojkotoi këtë komision edhe për faktin se prej datës 10 korrik kishte shpallur bojkot ndaj Kuvendit. Në përfundim të hetimit Kuvendi në seancë plenare shkarkoi dy anëtarët e sipërpërmendur për një sërë arsyesh të paraqitura në raportin përfundimtar.

Me vendimin nr. 81/2014, datë 23.10.2014, me propozimin e një grupi deputetësh të PD-së, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi miratoi ngritjen e komisionit hetimor për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore. Veprimtaria e këtij komisioni hetimor vazhdon ende.

Së fundi, me vendimin nr. 82/2014, datë 23.10.2014 u ngrit komisioni hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike dhe shoqëritë tregtare shtetërore. Edhe ky komision u ngrit mbi bazën e kërkesës së deputetëve të Grupit Parlamentar të PD-së. Veprimtaria e këtij komisioni hetimor vazhdon ende.

### **Kontrolli parlamentar në komisionet e përhershme**

Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare është shtrirë edhe në drejtim të forcimit të rolit kontrollues që ka Kuvendi ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Ky kontroll, sipas komisioneve, paraqitet si vijon:

*Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut janë zhvilluar 7 seanca dëgjimore për shqyrtimin e 7 raporteve vjetore të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj dhe janë miratuar projektrezolutat për vlerësimin e veprimtarisë së tyre. Para shqyrtimit të raporteve vjetore në Komision ato u janë dërguar për mendim grupeve të interesit dhe*



institucioneve të tjera.

Është zhvilluar një seancë dëgjimore me ministrin e Drejtësisë lidhur me zbatimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”.

Menjëherë pas daljes së raportit të progresit të Komisionit European në tetor 2013 dhe 2014, Komisioni zhvilloi seanca të posaçme dëgjimore me institucionet e pavarura dhe ato të ekzekutivit që janë në fushën e përgjegjësisë së tij. Kjo procedurë parlamentare ka shërbyer si shtysë për të nxitur përgjegjshmërinë institucionale të Kuvendit të Shqipërisë dhe për të rritur shkallën e transparencës dhe të llogaridhënies përpara opinionit publik.

Janë zhvilluar 8 seanca dëgjimore për raportin e progresit për vitin 2014 me institucionet si vijon: ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesave, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Avokatin e Popullit.

Gjithashtu janë miratuar projektrezolutat:

- ◆ “Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit”;
- ◆ “Për vlerësimin e punës së Departamentit të Administratës Publike për vitin 2013”;
- ◆ “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2013”;
- ◆ “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2013”;
- ◆ “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive për vitin 2013”;
- ◆ “Për vlerësimin e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2013”;
- ◆ “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Në këtë Komision është shqyrtuar raporti i grupit të deputetëve për kontrollin në ILDKPKI dhe kërkesa e tyre për shkarkimin e inspektoreve të përgjithshme, raportet e veçanta të Avokatit të Popullit, të cilat janë shpërndarë nga Kryetari i Kuvendit dhe janë në proces shqyrtimi nga nënkomisionet përkatëse parlamentare sipas fushave që ato mbulojnë, si dhe janë miratuar projektvendimet për miratimin e strukturës dhe organikës së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj të veçantë.

***Në Komisionin për Integrimin European*** janë zhvilluar 5 seanca dëgjimore me anëtarë të kabinetit qeveritar me tematikën: “Për administratën publike, raportim mbi raportin e progresit për vitin 2013, si dhe mbi ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” (znj. Milena Harito); për 5 prioritetet (z. Erion Veliaj) dhe projektligji “Për zbatimin e fondeve IPA në bujqësi” (z. Edmond Panariti).

***Në Komisionin për Politikën e Jashtme*** janë zhvilluar 4 seanca dëgjimore lidhur me qëndrimin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s për situatën në Ukrainë, lidhur me faktin që Shqipëria këtë vit (2014) merr presidencën në Procesin e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP), mbi zbatimin e deritanishëm të ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë në përfaqësitë tona jashtë shtetit, si dhe për ecurinë e reformimit të tij, mbi ecurinë e marrëveshjes së toponimeve me Greqinë. Po ashtu janë zhvilluar dhe 5 takime informimi për ecurinë e procesit të integritit european të Shqipërisë dhe hapat e ndërmarrë për marrjen e statusit të vendit kandidat, mbi situatën paszgjedhore dhe tensionet etnike në Maqedoni, rreth marrëdhënieve dypalëshe dhe presidencës italiane të BE-së në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2014, rreth zhvillimeve të fundit në Kosovë, rreth konferencës së shteteve të Ballkanit



Perëndimor në Berlin dhe samitit të NATO-s në Uells, si dhe mbi programin, përparësitë dhe veprimtaritë e qeverisë shqiptare në kuadrin e marrjes së kryesisë së SEECp-it nga ana e Shqipërisë.

Puna në **Komisionin për Ekonominë dhe Financat** është fokusuar dhe në drejtim të mbikëqyrjes për institucionet që raportojnë pranë Komisionit, si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të cilin u miratua dhe një ligj i ri, i cili pavarëson dhe përforcon rolin e këtij organi kushtetues, jetik në kontrollin e financave publike. Për këto institucione janë hartuar rezoluta të cilat targetojnë problematikat kryesore në veprimtarinë e këtyre institucioneve. Për sa i përket realizueshmërisë së rekomandimeve të Komisionit nga ana e këtyre institucioneve, një përgjigje përfundimtare do të arrihet gjatë raportimeve vjetore të këtyre institucioneve pranë komisionit në vitin 2015. Gjithashtu në kuadër të kontrollit parlamentar janë zhvilluar seanca dëgjimore me ministren e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, zonjën Eglantina Gjermeni, për çështjen e politikave të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit për kreditë dhe qiratë për strehim, me guvernatorin e Bankës së Shqipërisë për vjedhjen e ndodhur në këtë institucion, me inspektoren e përgjithshme të Bankës së Shqipërisë Elivar Golemi, po për këtë çështje, ku inspektorja nuk u paraqit, dhe me ish-inspektorin e përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë gjatë viteve 2006-2010 Teuta Baleta, po për çështjen në fjalë.

**Komisioni për Sigurinë Kombëtare** gjatë periudhës në fjalë ka ushtruar të drejtën e kontrollit parlamentar në dy drejtime: me anë të seancave dëgjimore e raportimeve dhe me anë të kontrollit direkt parlamentar. Më konkretisht janë mbajtur dy seanca dëgjimore, përkatësisht me ministrin e Brendshëm, z. Sajmir Tahiri, dhe me zëvendësministrin e Jashtëm Sokol Dervishi.

Dy nga katër raportimet janë mbajtur të përbashkëta me Komisionin e Ligjeve. Përkatësisht raportimi i Avokatit të Popullit dhe ai i Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu është zhvilluar një seancë raportuese me kreun e Shërbimit Informativ Shtetëror, z. Visho Ajazi (Lika). Për me tepër, kontrolli direkt parlamentar është ushtruar me anë të ngritjes së grupit të kontrollit për SHISH-in në mbledhjen e datës 23.04.2014.

Në **Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin** janë zhvilluar 5 seanca dëgjimore për prezantimin e ecurisë së procesit për përcaktimin e zonave me përparësi turizmin, për ecurinë e procesit të legalizimeve, për problemin e ujësjellës-kanalizimeve, seancë dëgjimore me drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe me operatorët e telefonisë celulare në treg, AKEP-in dhe Autoritetin e Konkurrencës.

Në **Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë** janë zhvilluar seanca dëgjimore në ushtrim të funksionit të kontrollit parlamentar (*1 seancë për dhënie informacioni, 5 seanca dëgjimore, 2 seanca për shqyrtim raporti*) me tematikë: për dhënie informacioni nga ministri i Shëndetësisë për situatën epidemiologjike aktuale në vend, lidhur me procedurat e prokurimit për blerjen e barnave dhe arsytet e ndërhyrjes së ministrit në ndryshimin e kriterëve të përcaktuara më parë; seancë dëgjimore me fëmijët lidhur me shqetësimet e tyre për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, në kuadër të Ditës Botërore të të Moshuarve, në kuadër të Ditës Botërore të Diabetit. Raportet e shqyrtuara janë: raporti vjetor për vitin 2013 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe raporti i veçantë i Avokatit të Popullit “Për gjendjen e spitaleve në Shqipëri”.

**Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje** ka shqyrtuar raportin e veçantë të Avokatit të Popullit “Për të drejtat e personave LGBT” dhe raportin e veçantë të Avokatit të Popullit “Për gjakmarrjen”.





**Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut** ka zhvilluar seancë dëgjimore për kartën e shoqërisë civile të depozituar në Kuvend nga grupi i punës “Për mjedisin mundësues për shoqërinë civile”, seancë dëgjimore me organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të Këshillit të Ministrave për shqyrtimin e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “Për gjakmarrjen”, si dhe seancë dëgjimore me organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të Këshillit të Ministrave për shqyrtimin e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “Për të drejtat e personave LGBT”. Janë zhvilluar dhe vizita monitoruese në institucionet e vuajtjes së dënimit.

**Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik** ka zhvilluar seancë dëgjimore me KDRTSH-në për raportin e veprimtarisë 1-vjeçare të RTSH-së (2013), seancë dëgjimore me AMA-n për raportin e veprimtarisë njëvjeçare të AMA-s (2013), seancë dëgjimore me ministren e Arsimit dhe Sportit, znj. Nikolla, për Maturën Shtetërore, seancë dëgjimore me ministren e Arsimit dhe Sporteve për rezultatet e inspektimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe pritshmëritë nga reforma e ndërmarrë në sistemin e arsimit parauniversitar në tërë komponentet e tij.

Funksioni i kontrollit parlamentar së bashku me atë legjislativ garantojnë ekuilibrin e pushteteve dhe afirmojnë rolin e Kuvendit si mbrojtës i interesave të popullit.

Ushtrimi sa më efikas dhe transparent i kontrollit parlamentar mbi organet e pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj që raportojnë dhe informojnë Kuvendin e Shqipërisë, duke respektuar parimin kushtetues *check and balance*, siguron një mjet vital në realizimin e kontrollit parlamentar edhe ndaj qeverisë, politikave e strategjive të zbatueshme të saj, si dhe impaktit që ato kanë pasur në forcimin e shtetit të së drejtës.

Kuvendi i Shqipërisë ka një sërë mekanizmesh për monitorimin e legjislacionit dhe kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të pavarura dhe efikasitetin e veprimtarisë së tyre specifike të rregulluara me ligjet përkatëse nëpërmjet mekanizmit të:

- raportimit nga ana e tyre në Kuvend;
- alokimit të fondeve buxhetore;
- miratimit të strukturave dhe kategorizimit të pagave;
- propozimeve dhe dhënies së mendimit për amendamente të ligjit;
- emërimit të anëtarëve në organet kolegjiale dhe titullarëve në ato monokratike;
- shkarkimit të anëtarëve në organet kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Mbështetjen për realizimin e këtyre raporteve e kryen **Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura** në Kuvendin e Shqipërisë. Shërbimi i Monitorimit zë një vend të rëndësishëm në administratën e Kuvendit për shkak të misionit që ka në funksion të mbështetjes së organeve të Kuvendit, në ushtrimin prej tyre të funksionit të kontrollit parlamentar për zbatimin e legjislacionit dhe ecurisë institucionale, sipas fushave dhe objektit të veprimtarisë së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Shërbimi ofron një gamë të gjerë materialesh, si: analiza ligjore, teknike, buxhetore, relacione, informacione të ndryshme periodike, statistika, raporte përmbledhëse, hartim rezolutash dhe projektvendimesh për ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj që raportojnë në Kuvend dhe zgjidhen e shkarkohen prej tij.

Gjatë vitit 2014 është forcuar më tej bashkëpunimi institucional dhe ka një evidentim më të saktë e të rregullt të çështjeve që shqetësojnë institucionet e pavarura në aspektin e zbatimit të legjislacionit bazë mbi të cilën operojnë këto institucione, si dhe ndërveprimet me organet e tjera ligjzbatuese. Gjatë vitit 2014 është synuar zhvillimi i Shërbimit, me qëllim fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të komisioneve parlamentare, duke ndjekur zbatimin e legjislacionit në funksion të të cilit këto institucione ndërtohen dhe veprojnë, përmes ndjekjes në mënyrë periodike të punës dhe të përmbushjes së detyrimeve



ligjore dhe rekomandimeve të Kuvendit.

Në krahasim me vitin 2013 gjatë vitit 2014 niveli i progresit i Shërbimit ka tregues pozitiv dhe të shtuar, ku nëpërmjet punës së gjithanshme monitoruese ka funksionuar si hallkë ndërmjetëse e informimit të organeve të Kuvendit. Gjithashtu Shërbimi ka evidentuar dhe orientuar drejt për zgjidhjen e një sërë situatave të ndryshme ligjore të krijuara gjatë veprimtarisë së punës së një institucioni të pavarur, si dhe ka shtuar sasinë dhe cilësinë e ekspertizës me materiale teknike e ligjore për çdo procedurë parlamentare të zhvilluar gjatë vitit 2014.

Shërbimi i Monitorimit ka paraqitur oponentin për 14 raporte vjetore të institucioneve, si: KMDHP, Avokati i Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prokuroria e Përgjithshme, KQZ, ILDKPKI, DAP, KLSH, Banka e Shqipërisë, AKEP-i, ERE, AMA dhe Këshilli Drejtues i RTSH-së, KMD.

Viti	Raportime institucionesh	Oponenca të Shërbimit të Monitorimit	Hartim rezolutash
<b>Viti 2014</b>	17	15	15
<b>Viti 2013</b>	13	9	9

Për herë të parë gjatë vitit 2014 Shërbimi i Monitorimit zgjeroi objektin e veprimtarisë së tij për monitorim, duke përfshirë edhe Prokurorinë, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Bankën e Shqipërisë, tri institucione të rëndësishme kushtetuese, të cilat raportojnë në Kuvend çdo vit mbi bazë të detyrimit përkatës ligjor. Edhe për këto institucione është hartuar analiza për raportin vjetor dhe u është dërguar Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat, si komisione përgjegjëse.

Gjatë vitit 2014 Kuvendi i Shqipërisë ka shqyrtuar të gjitha raportimet vjetore të institucioneve të pavarura në komisionet përgjegjëse parlamentare dhe brenda gjysmës së vitit janë votuar në seancë plenare të gjitha rezolutat për secilin institucion.

Rezolutat kanë qenë të përmirësuar si në përmbajtje të konstatimeve, ashtu dhe në tipologjinë e rekomandimeve të dhëna për vitin vijues. Në bazë të evidentimit të lartë të çështjeve dhe vërejtjeve përkatëse për nivelin e punës institucionale Kuvendi ka përcaktuar detyra dhe afate konkrete për institucionet përkatëse, duke bërë kështu të mundur një monitorim më efektiv të veprimtarisë së këtyre institucioneve, e rrjedhimisht një rritje të rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë dhe rritje të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve të pavarura.

### **Shqyrtimi i projektbuxhetit të institucioneve të pavarura**

Në lidhje me këtë detyrë të rëndësishme të Shërbimit të Monitorimit në nëntor 2014 u shqyrtua në komisionet parlamentare projektligji “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”, pjesë e të cilit ishte edhe buxheti i disa prej institucioneve të pavarura, për të cilat Shërbimi i Monitorimit paraqiti relacionet përkatëse.

U hartuan analiza krahasimore të detajuara dhe të shoqëruara me tabelat përkatëse për buxhetet e secilit prej tyre, duke evidentuar në terma financiarë krahasueshmërinë e realizimit të buxhetit faktik vjetor të fondeve buxhetore dhe mënyra e përdorimit të tyre, si dhe prioritetet që kanë nevojë për fonde shtesë. Për buxhetin e shtetit të vitit 2015 kanë adresuar kërkesa dhe janë dëgjuar në seanca dëgjimore institucione si Avokati i Popullit, Prokuroria e Përgjithshme, ILDKP-ja, KMD-ja, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, KQZ-ja, KMDHP-ja, RTSH-ja.

Ndër veprimtaritë e këtij Shërbimi spikatin edhe relacionet për raportime të veçanta të disa institucioneve kushtetuese në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, analizat për gjetjet dhe




Miratimi i buxhetit të institucioneve të pavarura	Vërejtje për buxhetet e institucioneve nga Shërbimi i Monitorimit	Sugjerime për buxhetet e institucioneve të pavarura nga Shërbimi i Monitorimit
Numri total	8	8

rekomandimet e raportit të progresit për vitin 2014 për institucionet kushtetuese dhe të pavarura, për të cilat u organizuan seanca të posaçme dëgjimore, analizat krahasimore të legjislacionit të institucioneve të pavarura dhe opinionet ligjore për amendamente në projektligjet e shqyrtuara në Kuvend për disa institucione të pavarura

Duke u mbështetur në analizën krahasuese të punës së Shërbimit të Monitorimit me vitin 2013, pavarësisht problemeve të hasura, vihet re një rritje në mënyrë të ndjeshme e performancës për sa i përket sasisë dhe cilësisë së informacionit të ardhur dhe të mbledhur nga Shërbimi gjatë veprimtarisë monitoruese ndaj institucioneve që monitorohen. Kjo gjë shihet qartë edhe në tabelën bashkëngjitur këtij raporti vjetor, që jep në mënyrë të detajuar gjithë veprimtarinë e Shërbimit të Monitorimit, ku konstatohet një rritje e gjithanshme e zgjerimit të objektit të punës së SHMI-së dhe e tipologjisë së gjerë të dokumenteve të prodhuara jo vetëm lidhur me objektin e punës së Shërbimit.

## Kapitulli 3

### FUNKSIONI ZGJEDHËS



Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në organe kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj gjatë vitit 2014 Kuvendi e ka ushtruar këtë funksion duke zgjedhur e plotësuar vendet vakante në institucionet përkatëse. Kandidaturat e propozuara nga Presidenti i Republikës, Këshilli i Ministrave dhe organet e tjera janë shqyrtuar e diskutuar me transparencë

të plotë. Secili kandidat është thirrur e dëgjuar në seanca dëgjimore publike në komisionet përkatëse. Në vijim seanca plenare ka vendosur për çdo kandidaturë të propozuar.

#### *Mosdhënie pëlqimi në organet kushtetuese: Gjykata e Lartë*

Kuvendi nuk ka dhënë pëlqimin për dekrete të Presidentit që kanë të bëjnë me emërimet në Gjykatën e Lartë. Konkretisht për z. Petrit Ceno, z. Gjovalin Pernoca, z. Alaudin Malaj, z. Sokol Ngresi dhe znj. Elona Stavri.

#### *Zgjedhjet dhe shkarkimet në organet kushtetuese: Banka e Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë*

Me vendimin nr. 64 Kuvendi ka shkarkuar nga detyra anëtarin e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht guvernatorin Ardian Fullani për shkak të vjedhjes së madhe që ndodhi në këtë institucion.

Me vendimet nr. 111, nr. 112 dhe nr. 113 u zgjodhën anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë z. Tonin Kola, znj. Natasha Ahmetaj dhe z. Gent Sejko. Ky i fundit u zgjodh guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Ndërsa me vendimet nr. 79 dhe nr. 80 u shkarkuar nga funksioni i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë zotërinjtë Elvis Çefa dhe Lulzim Lelçaj dhe në vend të tyre u zgjodhën znj. Albana Shtylla dhe z. Vangjel Kosta.

#### *Zgjedhjet dhe shkarkimet në institucione të ngritura me ligj*

Me vendimet nr. 6 e nr. 7 z. Maksim Shuli dhe z. Petrit Ahmeti u zgjodhën anëtarë të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, ndërsa me vendimet nr. 20, nr. 21, nr. 22 z. Ermir Kapedani, z. Arben Shkëmbi



dhe znj. Etilda Gjonaj u zgjodhën komisionerë në institucionin e Avokatit të Popullit. Me vendimet nr. 14, nr. 52, nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87 Kuvendi zgjodhi z. Shkëlqim Gani inspektor të përgjithshëm të Inspektoriatit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, z. Besnik Dervishi komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe znj. Pranvera Strakosha komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Me vendimet nr.74 dhe nr.75 u zgjodhën anëtarë të Bordit të Autoritetit të Medieve Audiovizive z. Gledis Gjipali dhe z. Pirro Misha, ndërsa me vendimin nr. 94 zoti Gent Sala u zgjodh kryetar i këtij institucioni.

Me vendimet nr. 99, nr. 100, nr. 101, nr. 102, nr. 103 z. A. Mato, V. Sulçe, H. Haliti, Xh. Aliu dhe V. Grosha u zgjodhën anëtarë të Këshillit Drejtues të Televizionit Shqiptar.

Me vendimet nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110 u zgjodhën anëtarë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare znj. Enkeleda Shehi, znj. Mimoza Kaci dhe z. Arian Salati.

Së fundi, me vendimin nr. 64 Kuvendi shkarkoi nga detyra inspektoren e përgjithshme, znj. Elivar Golemi, për shkak të vjedhjes që ndodhi në këtë institucion.

Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i krerëve dhe anëtarëve të institucioneve monokratike dhe kolegjiale, kushtetuese dhe të krijuara me ligj është një detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet organike. Komisionet e përhershme, në përmbushje të kërkesave procedurale të parashikuar nga neni 111 i Rregullores së Kuvendit, e kanë ushtruar këtë të drejtë duke ofruar një qasje të re, bazuar në Kushtetutë, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe rregullat procedurale të sanksionuara në ligje të ndryshme.

Komisionet e përhershme gjatë zhvillimit të 18 seancave dëgjimore kanë kërkuar përmbushjen jo vetëm të kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidaturave të paraqitura, por kanë bërë edhe vlerësimin e meritës dhe të profesionalizmit mbi bazën e respektimit të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Gjithashtu komisionet e përhershme kanë forcuar kuadrin ligjor të organizimit dhe funksionimit të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, duke parashikuar procedura emërimi transparente publike dhe gjithëpërfshirëse të zgjedhjes së titullarëve të atyre institucioneve që nuk e kanë të parashikuar në ligj mënyrën e zgjedhjes. Ky angazhim është materializuar me anë të krijimit të praktikave pozitive, të cilat sollën reflektimin e ndryshimeve ligjore në disa prej nismave të sjella në ligjet organike të këtyre institucioneve gjatë kësaj periudhe si nga Këshilli i Ministrave, ashtu dhe nga vetë deputetët. Praktika e përzgjedhjes së Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil shënoi një kthesë të rëndësishme në veprimtarinë parlamentare të hapjes së Kuvendit drejt publikut, duke garantuar një proces tejet transparent dhe gjithëpërfshirës, bazuar në vullnetin e shoqërisë dhe rritjen e besimit në publik.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Kuvendit të Shqipërisë i lindi detyrimi ligjor për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij institucioni të pavarur, për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil dhe garantimin e qëndrueshmërisë në detyrë të nëpunësve civil si dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, bazuar në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Europian dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të bëra ndër vite në raportet e progresit të KE-së, Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi një proces të hapur, publik, transparent, gjithëpërfshirës dhe konsensual për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Me të njëjtën procedurë Kuvendi zgjodhi edhe 2 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si dhe nisi të njëjtat procedura për zgjedhjen e inspektorit të përgjithshëm të këtij institucioni.



## Kapitulli 4

### VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2014 në fokus të veprimtarisë të marrëdhënieve me jashtë ka qenë aktivizimi dhe forcimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit dhe vendet me të cilat Kuvendi i Shqipërisë nuk ka pasur shkëmbime dhe me të cilat vendi ynë ka interesa strategjike. Viti 2014 ishte një vit mjaft i rëndësishëm për sa u përket veprimtarive ndërkombëtare parlamentare dhe diplomacisë parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë.

#### *Objektivat e veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë për këtë periudhë kanë qenë:*

- ◆ Intensifikimi i punës në nivel parlamentar për avancimin me axhendën europiane të Shqipërisë: marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE.
- ◆ Rritja dhe forcimi i kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare.
- ◆ Njohja e vendit tonë dhe potencialeve që ai ofron për të thithur investimet e huaja.
- ◆ Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta, intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.

Për arritjen e këtyre objektivave Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, që përmbledhet si vijon:

- ◆ 6 vizita zyrtare të Kryetarit të Kuvendit në vende të tjera (vizitë zyrtare në Danimarkë, në Kuvajt, në Izrael, në Portugal, në Azerbajxhan dhe në Marok);
- ◆ 8 vizita zyrtare të kryetarëve të parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës në Shqipëri (kryetari i parlamentit të Libanit, kryetari i Senatit të Francës, kryetari i parlamentit të Greqisë, kryetari i parlamentit të Kroacisë, kryetari i Senatit të Italisë, kryetari i parlamentit japonez, kryetari i parlamentit të Çekisë dhe kryetari i Asamblesë së Madhe të Turqisë)<sup>1</sup>;
- ◆ 3 pjesëmarrje të delegacioneve parlamentare të kryesuar nga Kryetari në veprimtari shumëpalëshe;
- ◆ 5 takime shumëpalëshe të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë: Konferenca VII e Kryetarëve të Parlamenteve të NAJ-it; konferenca e Kartës së Adriatikut, takimet e PABSEC-ut, takimi i grupit të punës të SEECP-it;
- ◆ 4 vizita zyrtare në Tiranë të grupeve parlamentare të miqësisë nga parlamente të vendeve të ndryshme;
- ◆ 60 takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete të huaja: presidentë, kryeministra, ministra, delegacione parlamentare e personalitete të tjera të shquara.

---

<sup>1</sup>Kryetari i parlamentit grek, z. Meimarakis, dhe kryetari i parlamentit kroat ndodheshin në Shqipëri në kuadër të Konferencës së 7-të të Nismës Adriatiko-Joniane dhe me këtë rast zhvilluan edhe takime dypalëshe.



## INTEGRIMI EUROPIAN

Ngjarja më e rëndësishme e integritit evropian të Shqipërisë ishte marrja e statusit të vendit kandidat më 27 qershor 2014, që përbën një ngjarje tepër pozitive jo vetëm për vendin tonë dhe popullin shqiptar, por edhe për rajonin dhe vetë BE-në. Një Shqipëri më pranë BE-së do t'i shërbejë afirmimit të rolit konstruktiv të saj në rajon dhe do të rrisë kredibilitetin dhe ndikimin pozitiv në zhvillimet në rajon.

**7 maj.** Z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit, priti në takim një delegacion të Drejtorisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian, i përbërë nga z. Jean-Eric Paquet, drejtor i Zgjerimit në KE, z. Vassilis Maragos, shef i Sektorit për Shqipërinë në Drejtorinë e Zgjerimit të KE-së, dhe z. Clive Rumbold, i ngarkuar me punë në Delegacionin e BE-së.

Z. Vassilis Maragos, shef i Sektorit për Shqipërinë në Drejtorinë e Zgjerimit të KE-së, zhvilloi një takim të veçantë edhe me znj. Albana Shtylla, Sekretare e Përgjithshme e Kuvendit. Tema e bisedës ishte funksionimi i Kuvendit dhe asistencë e BE-së.

**22 maj.** Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, priti drejtorin e përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Evropian, z. Christian Danielsson, me të cilin bisedoi mbi përgatitjen e raportit të progresit të Komisionit Evropian, ecurinë e reformave të ndërmarra nga qeveria dhe zhvillimet e fundit politike në vend.

**2-3 qershor COSAP.** Takimi IX i Komisioneve parlamentare për Integrimin Evropian të vendeve të Europës Juglindore, Mal i Zi. Morën pjesë:

- Z. Ben Blushi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë;
- Z. Genc Pollo, kryetar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik;
- Denis Gila, këshilltar i Komisionit për Integrimin Evropian.

**30 qershor.** Vizita e z. José Manuel Barroso, Presidenti i Komisionit Evropian, në Tiranë.

Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, e vlerësoi vizitën e rëndësishme të Presidentit Barroso në Tiranë si një rikonfirmim të vëmendjes së Komisionit Evropian ndaj Shqipërisë vetëm disa ditë pas miratimit nga Këshilli Evropian të statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE. Z. Meta shprehu mirënjohjen e Kuvendit të Shqipërisë për rolin personal të z. Barroso dhe për punën e palodhur të Komisionit Evropian në mbështetje të Shqipërisë dhe axhendës së saj europiane.

Presidenti i Komisionit Evropian, z. José Manuel Barroso, e falënderoi Kryetarin e Kuvendit për ftesën për mbajtjen e fjalës përshëndetëse në seancë plenare dhe vuri në dukje se pas miratimit të statusit të vendit kandidat Bashkimi Evropian do t'i kushtojë gjithnjë e më tepër vëmendje Shqipërisë dhe ecurisë së axhendës së saj europiane.

**29 shtator.** Vizita në Tiranë e komisionerit evropian për Zgjerimin Stefan Fyle dhe takimi me Kryetarin e Kuvendit, z. Ilir Meta.

Z. Meta theksoi se pas miratimit të statusit të vendit kandidat Shqipëria ndien më tepër përgjegjësi mbi supe dhe në këtë drejtim janë intensifikuar përpjekjet për avancimin e reformave kyçe, veçanërisht asaj në drejtësi. Në këtë kuadër u vlerësua mbështetja e pakursyer e Komisionit dhe e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Komisioneri për Zgjerimin, z. Stefan Fyle, vuri në dukje se përgjegjësitë e reja të Shqipërisë pas marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE kërkojnë më tepër pjekuri politike nga të gjitha palët në Kuvend dhe një përshpejtim të reformave kyçe.

**30 nëntor–2 dhjetor.** Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit të Integritit, znj. Majlinda Bregu, në takimin e radhës së COSAC.



## VEPRIMTARI TË DELEGACIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE

### *Bashkëpunimi parlamentar në kuadër të organizatave ndërkombëtare*

Delegacionet parlamentare ruajnë dhe zhvillojnë kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit me organizmat ndërkombëtarë respektivë, duke kontribuar në promovimin e vlerave dhe parimeve të lirisë dhe demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut, të lirive themelore dhe të shtetit ligjor.

Kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit synojnë të zhvillojnë më tej dimensionin parlamentar të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në Kuvendin e Shqipërisë, në mbështetje të pikës 3 të nenit 7 të Rregullores së Kuvendit, janë ngritur delegacionet e përhershme parlamentare pranë organizatave ndërkombëtare, veprimtaritë e të cilave *për vitin 2014* kanë qenë si më poshtë:

### **1. Parlamenti Europian**

Në nivel parlamentar dialogu politik ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së zhvillohet gjithnjë brenda kuadrit të MSA-së.

Delegacioni parlamentar shqiptar në PE përbëhet nga 14 anëtarë të përhershëm dhe 3 anëtarë zëvendësues.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**19–20 shkurt.** Seminari “Mbrojtja e shëndetit dhe e konsumatorit”. Në këtë aktivitet mori pjesë delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë, i përbërë nga deputetët Eduard Shalsi, Voltana Ademi dhe Egla Jera.

**11–13 mars.** Delegacioni i SACP-së në Strasburg. Mori pjesë delegacioni i Kuvendit i përbërë nga: z. Taulant Balla, kryetar i delegacionit; z. Aldo Bumçi, znj. Vasilika Hysi, z. Eduart Shalsi, z. Ben Blushi, z. Fatmir Xhafaj, z. Anastas Angjeli, z. Vangjel Tavo, znj. Majlinda Bregu, z. Genc Ruli, z. Eduart Halimi, z. Gert Bogdani, z. Genc Pollo, z. Famir Mediu, anëtarë; znj. Irma Pashkja, drejtoreshë e përgjithshme e Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë.

**19 mars.** Seminar, Bruksel. Në këtë aktivitet mori pjesë delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë i përbërë nga deputetët Ermonela Felaj, Armando Subashi dhe Bledar Miloti.

**9–10 qershor.** Takimi i Forumit Parlamentar të Cetinës, Cetinë.

Morën pjesë: znj. Vasilika Hysi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë; znj. Blerina Gjylameti, deputete e Kuvendit të Shqipërisë; znj. Esmeralda Shkja, deputete e Kuvendit të Shqipërisë.

**10–12 qershor.** Zoti Spartak Braho, kryetar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tbilisi (Gjeorgji). Delegacioni shqiptar kryesohej nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli.

**3 korrik.** Seminari parlamentar për Komunitetin e Energjisë. Morën pjesë deputetët Genc Ruli, Robert Bitri, Namik Kopliku dhe znj. Xhilda Pinci nga stafi i Kuvendit.

**21 nëntor.** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, mori pjesë në konferencën “Të drejtat themelore: mosdiskriminimi dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël, përfshirë LGBTI”, të organizuar nga Parlamenti Europian, Këshilli i Europës, presidenca italiane e Këshillit të BE-së dhe Kuvendi. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm edhe zëvendëspresidentja e Parlamentit Europian Ulrik Lunaçek, zëvendëskryeministri Niko Peleshi dhe shumë përfaqësues të tjerë të BE-së.

### **2. Asambleja Parlamentare e OSBE-së:**

OSBE-ja u krijua më 1970, fillimisht si Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (KSBE), me synimin për të shërbyer si një forum shumëpalësh për dialog dhe negociata midis Lindjes dhe





Perëndimit.

Aderimi i Shqipërisë në OSBE (ish-KSBE) është realizuar gjatë punimeve të Këshillit Ministror të Berlinit (19–20 qershor 1991). Vendi ynë e nënshkroi Aktin Final të Helsinkit më 16 shtator 1991 dhe Kartën e Parisit për një Europë të Re më 17 shtator 1991.

Gjatë viteve të fundit Shqipëria e ka rritur dukshëm profilin e saj në OSBE, ashtu sikurse në rajon dhe në arenën ndërkombëtare, duke ndikuar në ndryshimin rrënjësor të marrëdhënieve me OSBE-në.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**13–14 shkurt.** Sesioni i radhës i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, takimi i dimrit, Vjenë. Në këtë aktivitet mori pjesë delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë i përbërë nga deputetët Arta Dade, kryetare e delegacionit, Blendi Klosi dhe Eduart Selami, anëtar

**18–19 maj.** Delegacioni parlamentar shqiptar mori pjesë në Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, që u organizua në Zagreb (Kroaci). Morën pjesë: znj. Arta Dade, kryetare e delegacionit; z. Blendi Klosi, anëtar i delegacionit; z. Eduard Selami, anëtar i delegacionit; z. Arben Loku, sekretar i delegacionit.

**28 qershor–2 korrik.** Delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në sesionin e 23-të të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, që u organizua në Baku (Azerbajxhan). Morën pjesë: znj. Arta Dade, kryetare e delegacionit; z. Blendi Klosi, anëtar i delegacionit; z. Eduard Selami, anëtar i delegacionit; z. Arben Loku, sekretar i delegacionit.

**30 nëntor.** Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, znj. Arta Dade, mori pjesë në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare në Moldavi në cilësinë e kryetares së delegacionit të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Znj. Arta Dade përshëndeti përppjekjet e anëtarëve që u morën me administrimin e zgjedhjeve dhe vlerësoi angazhimin e grave në këtë proces.

### **3. Asambleja Parlamentare e Atlantikut të Veriut (NATO):**

NATO-ja u krijua më 4 prill 1949. Qëllimi themelor i kësaj organizate është mbrojtja e lirisë dhe siguria e të gjithë anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake.

NATO-ja synon të promovojë vlerat demokratike dhe të nxisë konsultimet dhe bashkëpunimin për mbrojtjen dhe sigurinë duke parandaluar konfliktet.

E angazhuar për zgjidhjen paqësore të konflikteve në rastet kur përppjekjet diplomatike dështojnë, ajo ka kapacitetet e nevojshme për të ndërmarrë operacione ushtarake dhe menaxhimin e krizave sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit (traktati themelues i NATO-s) ose nën mandatin e OKB-së, vetëm ose në bashkëpunim me vendet e tjera apo organizatat ndërkombëtare.

Shqipëria u pranua anëtare e NATO-s në vitin 2009.

Shqipëria përfaqësohet në Asamblesë Parlamentare të NATO-s nga një delegacion parlamentar, që përbëhet nga 4 anëtarë.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**15–18 shkurt.** Delegacioni i Kuvendit në NATO mori pjesë në punimet e Asamblesë, në Bruksel. Delegacioni përbëhej nga deputetët Pandeli Majko, Jozefina Topalli, Përparim Spahiu, Xhemal Qefalia dhe specialisti Dritan Delija.

**4–6 prill.** Takimi i Komisionit të Përgjithshëm Drejtues të Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Mori pjesë deputeti Pandeli Majko.

**21–25 nëntor.** Delegacioni i Kuvendit në NATO mori pjesë në punimet e Asamblesë të kësaj organizate, që u zhvillua në Hagë (Holandë).

**7–11 dhjetor.** Delegacioni i Kuvendit mori pjesë në *Trans-Atlantic Forum*, që u mbajt në Uashington DC (SHBA), NATO.



#### 4. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës:

Këshilli i Europës u krijua në vitin 1949 dhe është organizata kryesore europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përbëhet nga 47 vende anëtare, nga të cilat 28 janë anëtare të BE-së. Të gjitha shtetet anëtare kanë firmosur Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Shqipëria u anëtarësua në Këshillin e Europës më 13 korrik 1995.

Në 6-mujorin e dytë të vitit 2012 (23 maj–9 nëntor) Republika e Shqipërisë kryesoi Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës, për herë të parë që prej anëtarësimit të saj.

Shqipëria përfaqësohet në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës nga një delegacion parlamentar, që përbëhet nga 4 anëtarë përfaqësues dhe 4 anëtarë zëvendësues.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës mblidhet 4 herë në vit.

##### *Veprimtaritë për vitin 2014:*

**27–31 janar.** PACE, Strasburg. Delegacioni: Valentina Leskaj, Petrit Vasili, Oerd Bylykbashi, Ota Xhaçka.

**20–24 prill.** Delegacioni i Kuvendit merr pjesë në sesionin e radhës të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Strasburg (Francë). Morën pjesë: znj. Valentina Leskaj, kryetare e delegacionit; z. Petrit Vasili, anëtar e delegacionit,

**16 maj.** Delegacioni i Këshillit të Europës merr pjesë në takimin e Komisionit Monitorues të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, në Paris (Francë). Morën pjesë: znj. Valentina Leskaj, kryetare e delegacionit të Këshillit të Europës; z. Oerd Bylykbashi, nënkryetar i delegacionit.

**23–26 qershor.** Delegacioni i Kuvendit merr pjesë në sesionin e radhës të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, në Strasburg (Francë). Morën pjesë: znj. Valentina Leskaj, kryetare e delegacionit; z. Oerd Bylykbashi, anëtar i delegacionit; z. Eduard Shalsi, anëtar i delegacionit; znj. Silva Caka, anëtare e delegacionit; z. Vangjel Mita, drejtor i Protokollit.

**2–5 shtator.** Delegacioni i Kuvendit merr pjesë në takimin e Komisionit të Monitorimit të Këshillit të Europës, në Paris (Francë). Mori pjesë znj. Valentina Leskaj, kryetare e delegacionit të Këshillit të Europës.

**11–12 shtator.** Konferenca e Kryetarëve të Parlaenteve të Këshillit të Europës, Oslo (Norvegji).

Morën pjesë deputetët Vangjel Dule, nënkryetar i Kuvendit; znj. Valentina Leskaj dhe nga stafi i Kuvendit znj. Albana Shtylla, Sekretare e Përgjithshme, dhe znj. Irma Pashkja.

**29 shtator–3 tetor.** Delegacioni i Kuvendit merr pjesë në sesionin e radhës të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, në Strasburg (Francë). Morën pjesë: znj. Valentina Leskaj, kryetare e delegacionit; z. Oerd Bylykbashi, anëtar i delegacionit; z. Eduard Shalsi, anëtar i delegacionit; z. Petrit Vasili, anëtar i delegacionit.

**25 nëntor.** Shenjtëria e Tij Papa Françesku mbërriti në Strasburg. Kreu i Selisë së Shenjtë mbajti një fjalim në Parlamentin European dhe Këshillin e Europës. Në takimin e zgjeruar të Komisionit të Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës morën pjesë znj. Valentina Leskaj dhe z. Petrit Vasili.

**7–12 dhjetor 2014.** U zhvilluan në Paris mbledhja e Komisionit Politik dhe mbledhja e Komisionit të Monitorimit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Mori pjesë znj. Valentina Leskaj.

#### 5. Unioni Ndërparlamentar:

Unioni Ndërparlamentar (IPU) është organizata ndërkombëtare e parlaenteve, që u krijua në vitin 1889. Unioni punon në bashkëpunim të ngushtë me OKB-në, me të cilën ndan të njëjtat objektiva për paqen dhe bashkëpunimin midis popujve dhe forcimin e demokracisë. Gjithashtu Unioni kooperon edhe me organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, të cilat



synojnë të njëjtat qëllime.

Shqipëria përfaqësohet në IPU nga një delegacion parlamentar, që përbëhet nga 9 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari i Kuvendit.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**17–18 shkurt.** Seminari i parë rajonal me temë “Kontributi i parlamenteve në punën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara”, mbajtur në Bukuresht. Seminari u organizua nga Dhoma e Deputetëve e parlamentit Rumun dhe Unioni Ndërparlamentar për parlamentet nga Europa Qendrore dhe Lindore.

Në këtë aktivitet mori pjesë një delegacion i Kuvendit të Shqipërisë i përbërë nga deputetët Albana Vokshi, kryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, dhe znj. Olta Xhacka, anëtare e Komisionit për Politikën e Jashtme.

**16–21 mars.** Një delegacion i Kuvendit, i përbërë nga deputetët Arta Dade, Musa Ulqini, Luan Rama dhe Edi Paloka, mori pjesë në punimet e sesionit të Unionit Ndërparlamentar.

**12–16 tetor.** Vizitë në Gjenevë e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, në krye të një delegacioni parlamentar për të marrë pjesë në sesionin e 131-të të Unionit Ndërparlamentar (IPU). Në përbërje të delegacionit ishin edhe deputetët Arta Dade e Shpëtim Idrizi dhe zoti Ralf Gjoni.

## **VEPRIMTARI NË KUADËR TË NISMAVE RAJONALE**

### **1. Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP)**

Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP) filloi në vitin 1996 me takimin e ministrave të Punëve të Jashtme të Europës Juglindore, që u mbajt në Sofje (Bullgari), me synim promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe transformimin e rajonit në një zonë të paqes, sigurisë dhe stabilitetit.

SEECP përbëhet nga 12 vende anëtare: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia dhe Turqia.

Shqipëria është anëtare aktive e kësaj organizate rajonale dhe synon forcimin e dialogut politik, të fqinjësisë së mirë, të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes rajonal, forcimin e sigurisë etj.

Kryesimi i SEECP-së është njëvjeçar.

Në kuadër të presidencës së Asamblesë Parlamentare të SEECP vlen të përmendet se vendi ynë bën pjesë në trojkën e shteteve anëtare (Maqedoni, Rumani, Shqipëri).

**Shqipëria kryeson Asamblesë Parlamentare të SEECP për një periudhë njëvjeçare (qershor 2014–qershor 2015)**

Delegacioni parlamentar i SEECP-së përbëhet nga 3 deputetë.

Asambleja Parlamentare e SEECP-së mblidhet 1 herë në vit.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**14–16 mars.** SEECP, mbledhja e grupit të punës, në Rumani. Mori pjesë kryetari i delegacionit, deputeti Taulant Balla, dhe specialisti Genc Goli.

**9–11 maj.** Delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, mori pjesë në seancën përruese të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së në Bukuresht (Rumani). Në përbërje të delegacionit ishin edhe deputetët Taulant Balla, kryetar i delegacionit shqiptar të SEECP-së; Esmeralda Shkja, anëtare e delegacionit të SEECP-së; Pirro Kapurani, kryetar i Grupit të Miqësisë Shqipëri–Rumani, si dhe z. Ralf Gjoni, këshilltar i Kryetarit të Kuvendit për politikën e jashtme, z. Genci Goli, koordinatori kombëtar i SEECP-së, z. Kastriot Braho, oficer sigurie i Kryetarit të Kuvendit.

Në kuadër të konstituimit të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së u organizuan takime paralele



për konstituimin e tri komisioneve të AP të SEECP-së.

### *1. Komisioni i Përgjithshëm për Zhvillimin Social, Edukimin, Kërkimin dhe Shkencën*

Në takim morën pjesë përfaqësues të të gjitha vendeve anëtare të SEECP-së. Relatore e Komisionit u caktua znj. Esmeralda Shkja (Tiranë) dhe pas miratimit të axhendës si kandidaturë për marrjen e kryesimit të këtij komisioni u zgjodh znj. Gabriela Podaska për një mandat njëvjeçar, nga Rumania.

Takimi i ardhëm i Komisionit të Përgjithshëm për Zhvillimin Social, Edukimin, Kërkimin dhe Shkencën do të mbahet në datat 26–27 shkurt 2015 në Bukuresht (Rumani).

### *2. Komisioni i Përgjithshëm për Drejtësinë, Punët e Brendshme dhe Bashkëpunimin në Fushën e Sigurisë*

Në takim morën pjesë përfaqësues të të gjitha vendeve anëtare të SEECP-së. Relatore i komisionit u caktua znj. Luminata Adam (Bukuresht) dhe pas miratimit të axhendës si kandidaturë për marrjen e kryesimit të këtij komisioni u zgjodh z. Ali Sahin për një mandat njëvjeçar, nga parlamenti i Ankarasë.

Takimi i ardhshëm i Komisionit të Përgjithshëm për Drejtësinë, Punët e Brendshme dhe Bashkëpunimin në Fushën e Sigurisë do të mbahet më 9–10 shkurt 2015 në Stamboll.

### *3. Komisioni i Përgjithshëm i Ekonomisë, Infrastrukturës dhe Energjisë*

Në takim morën pjesë përfaqësues të të gjitha vendeve anëtare të SEECP-së. Relator i komisionit u caktua z. Ioannis Kefalogiannis (Athinë) dhe pas miratimit të axhendës si kandidaturë për marrjen e kryesimit të këtij komisioni u zgjodh z. Rumen Gechev për një mandat njëvjeçar, nga parlamenti i Sofjes. Takimi i ardhshëm do të mbahet më 15 mars 2015 në Sofje (Bullgari).

**23–24 tetor.** Deputetja Esmeralda Shkja, anëtare e Asamblesë Parlamentare të SEECP-së, mori pjesë në konferencën e 33-të parlamentare të vendeve baltike dhe në takimin e 20-të të Këshillit Baltik, në Talin (Estoni).

**7–8 nëntor.** U zhvilluan në Tiranë takimi i 13-të i grupit të punës të SEECP-së. Gjatë takimit u përgatit projektregullorja për sekretariatit e Asamblesë Parlamentare të SEECP-së dhe në takimin e radhës, që do të mbahet po në Tiranë, do të hartohet rregullorja e buxhetit të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së. Rregulloja e sekretariatit dhe ajo e buxhetit do të ndihmojnë në institucionalizimin e mëtejshëm të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së.

## **2. Bashkëpunimi Ekonomik me Detin e Zi**

Themeluar më 26 shkurt 1993 si një dimension parlamentar, Bashkëpunimi Ekonomik me Detin e Zi (BSEC) është një forum efektiv për dialogun ndërparlamentar në rajonin e Detit të Zi. Përbëhet nga 76 deputetë, që përfaqësojnë parlamentet kombëtare të shteteve anëtare.

PABSEC-u synon mobilizimin e përpjekjeve nga ana e parlamenteve kombëtare që kanë për qëllim promovimin e vlerave demokratike, sundimin e ligjit, të shoqërisë pluraliste dhe të ekonomisë së tregut.

Shqipëria përfaqësohet në PABSEC nga një delegacion parlamentar, që përbëhet nga 4 anëtarë.

### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**11–12 mars.** Takimi i 42-të i vendeve të PABSEC-it, në Tiranë. Mori pjesë kryetari i delegacionit të PABSEC-it për Shqipërinë, deputeti Namik Dokle, delegacioni i Azerbajxhanit, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Greqisë, Moldavisë, Ruisë, Turqisë dhe Unionit Turk si dhe stafi i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë.

**12–14 maj.** Asambleja Parlamentare e PABSEC-it në Athinë (Greqi).

Kuvendi i Shqipërisë në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Namik Dokle, kryetar i delegacionit



shqiptar të PABSEC-ut.

**23–26 maj.** Deputeti Namik Dokle mori pjesë në monitorimin e zgjedhjeve presidenciale në Ukrainë në cilësinë e kryetarit të delegacionit të PABSEC-ut.

**7–10 dhjetor 2014.** Në datën 8 dhjetor u zhvillua mbledhja e Komisionit të Përhershëm të PABSEC-ut, ku morën pjesë kryetarët e delegacioneve të PABSEC-ut. Në datën 9 dhjetor u zhvillua sesioni plenar i PABSEC-ut me pjesëmarrjen e delegacionit të PABSEC-ut. Morën pjesë deputetët Musa Ulqini dhe Blendi Klosi.

### **3. Konferenca për Bashkëpunimin në Mesdhe**

Sekretariati i Bashkëpunimit për Mesdheun (UpM) u krijua nga 43 kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve euromesdhetare më 13 korrik 2008 në Paris. Ministrat e Punëve të Jashtme gjatë takimit të tyre në Marsejë më 4 nëntor 2008 vendosën që selia e Sekretariatit të ishte në Barcelonë.

Bashkimi për Mesdheun është një partneritet shumëpalësh, qëllimi i të cilit është promovimi i potencialeve të integritit rajonal të vendeve euromesdhetare.

Delegacioni parlamentar i UpM-së përbëhet nga 3 deputetë.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**26-27 mars.** U zhvillua në Barcelonë konferenca “Fuqizimi sociaekonomik i grave: projekte për progres”. Mori pjesë anëtarja e delegacionit të UpM-së, deputetja Klodiana Spahiu.

### **4. Nisma e Europës Qendrore**

Nisma e Europës Qendrore (CEI) është krijuar më 11 nëntor 1989 dhe sot përbëhet nga 18 vende anëtare: Shqipëria, Austria, Bjellorusia, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Hungaria, Italia, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia dhe Ukraina.

Objekti i Nismës është thellimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit në fushën politike dhe ekonomike, si dhe sigurimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në kuadër të proceseve të integritit. Nisma ka si qëllim integritin e ekonomive të këtyre vendeve në Europë, me synim anëtarësimin e tyre të afërt në Bashkimin Europian.

Shqipëria, si vend anëtar i Nismës së Europës Qendrore që prej vitit 1996, përpiqet të luajë një rol aktiv në të.

Delegacioni parlamentar i CEI-t përbëhet nga 3 deputetë.

Asambleja Parlamentare e Nismës së Europës Qendrore mbledhet një herë në vit.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**10–12 qershor.** Delegacioni i Kuvendit mori pjesë në seancën e Komisionit Parlamentar të CEI-t në Vjenë (Austri). Mori pjesë deputetja Monika Kryemadhi, nënkryetare e delegacionit shqiptar të Nismës së Europës Qendrore

### **5. Asambleja Parlamentare e Mesdheut (PAM):**

Asambleja Parlamentare e Mesdheut është forumi në të cilin parlamentet e vendeve të Mesdheut mbledhen për të arritur qëllimet e tyre të përbashkëta për krijimin e një mjedisi sa më të mirë politik, social, ekonomik e kulturor dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së popujve të vendeve që ato përfaqësojnë.

PAM-i është një organizatë rajonale ndërshtetërore, që gëzon statusin e vëzhguesit pranë Asamblesë



së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Ajo luan një roj kyç në rajon, duke mbështetur me aktivitetet e veta organizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë që janë përgjegjës për sigurinë, stabilitetin dhe paqen në Mesdhe. Që nga fillimi i saj Asambleja Parlamentare e Mesdheut ka qenë një ndër aktorët kryesorë të diplomacisë parlamentare rajonale.

Delegacioni parlamentar i PAM-it përbëhet nga 2 deputetë.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**19–22 janar.** Delegacioni i Kuvendit në PAM mori pjesë në punimet e Asamblesë në Marsejë. Delegacioni përbëhej nga Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, z. Dashmir Shehi, znj. Klodiana Spahiu dhe këshilltarët Krenar Hajdëri e Ralf Gjoni.

## **6. Nisma Adriatiko-Joniane (NAJ)**

Nisma Adriatiko-Joniane (NAJ) u themelua në konferencën për zhvillimin dhe sigurinë e detit Adriatik dhe Jon, mbajtur në Ankona (Itali) më 19–20 maj 2000, në të cilën morën pjesë kryetarët e qeverive dhe të shteteve Itali, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Greqi dhe Slloveni. Në fund të konferencës, në prani të Komisionit European, ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve pjesëmarrëse nënshkruan “Deklaratën e Ankonës”.

Filozofia e konferencës së Ankonës dhe e Nismës Adriatiko-Joniane në përgjithësi është që ta bëjmë pellgun e deteve Adriatik dhe Jon një pellg ku të mbizotërojë bashkëpunimi ekonomik, paqja dhe siguria. Ky pellg përbën, dhe duhet të përbëjë edhe në të ardhmen, një lidhje natyrore midis Bashkimit European dhe Europës Juglindore, midis Europës dhe Mesdheut.

Shqipëria ka pasur kryesimin e radhës të Nismës Adriatiko-Joniane në periudhën njëvjeçare qershor 2013–maj 2014.

Nisma Adriatiko-Joniane mbledhet një herë në vit.

#### ***Veprimtaritë për vitin 2014:***

**27–28 prill.** Konferenca XII e Kryetarëve të Paramenteve të Vendeve të Nismës Adriatiko-Jonianet, Tiranë. Morën pjesë: z. Ilir Meta, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë; z. Milorad •ivkoviç, Kryetar i parlamentit të Bosnjë-Hercegovinës; z. Evangelos Meimarakis, Kryetar i parlamentit të Greqisë; z. Josip Leko, Kryetar i parlamentit të Kroacisë; z. Suljo Mustafic, nënkryetar i parlamentit të Malit të Zi; znj. Polonca Komar, nënkryetare e parlamentit të Sllovenisë; z. Aldo Di Biagio, senator, Itali.

Në fjalët e tyre përshëndetëse Kryeministri Edi Rama dhe Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, kërkuan përfshirjen e Prishtinës dhe të Shkupit në Strategjinë e Bashkimit European për Rajonin Adriatiko-Jonian. Kjo qasje gjithëpërfshirëse është një vlerë e shtuar për vetë strategjinë *EUSAIR* dhe një kontribut i vyer për rritjen e parametrevë të stabilitetit, të sigurisë, prosperitetit dhe zhvillimit ekonomik për të gjithë rajonin tonë. Parlamentet e vendeve tona kanë një rol dhe peshë të veçantë në garantimin e suksesit të Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian, jo vetëm përmes rolit mbikëqyrës që ne ushtrojmë mbi qeveritë respektive, por edhe përmes intensifikimit konkret të bashkëpunimit ndërparlamentar në funksion të rritjes së efikasitetit të Nismës. Kryeministri u shpreh se angazhimi i qeverisë mbetet përmbushja e objektivave të Nismës Adriatiko-Joniane dhe atyre europiane, si një instrument në funksion të zhvillimit ekonomik e social.

Në këtë konferencë u miratua një deklaratë e përbashkët e kryetarëve të paramenteve, në të cilën u ra dakord që të ketë përfaqësi parlamentare pranë Nismës Adriatiko-Joniane. Përfaqësitë do të monitorojnë progresin e strategjisë europiane. Ky propozim u bë nga presidenca parlamentare e Shqipërisë.

**23–24 shkurt. Karta e Adriatikut:** Konferenca e Komisioneve të Sigurisë të Paramenteve të Kartës së Adriatikut A5 me temë: “Forcimi i bashkëpunimit ndërparlamentar - garanci e suksesit të Kartës së



Adriatikut–SHBA”. Morën pjesë përfaqësues të komisioneve të sigurisë të vendeve të Kartës së Adriatikut nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe nga shoqëria civile.

Të pranishëm në konferencë ishin: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta; kryetari i Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare, z. Spartak Braho; ministri i Punëve të Jashtme, z. Ditmir Bushati; ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ambasadori i SHBA-ve, z. Aleksandër Arvizu.

## **AKTIVITETE TË DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Gjatë vitit 2014 ka pasur aktivitete dhe shkëmbime në kuadër të grupeve të miqësisë, ku mund të përmendim vizitën e Grupit të Miqësisë të parlamentit të Kuvajtit, vizitën e Grupit të Miqësisë të parlamentit të Izraelit dhe vizitën e Grupit Parlamentar të Miqësisë Poloni–Shqipëri. Janë zhvilluar dhe vizita të grupeve të miqësisë të Kuvendit të Shqipërisë në vende të tjera, si: vizita në Francë e Grupit të Miqësisë Shqipëri–Francë dhe vizita në Kinë e Grupit të Miqësisë Shqipëri–Kinë. Grupet e miqësisë Shqipëri–Gjermani, Shqipëri–Itali, Shqipëri–Francë etj. kanë organizuar edhe aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me ambasadat e vendeve të akredituara në Tiranë.

Aktivitete të tjera të deputetëve përfshijnë:

Vizita e kryetarit të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, z. Eduard Shalsi, në Itali më 9–11 shkurt 2014.

Organizimi i aktivitetit të Aleancës së Grave Deputete me rastin e festës së 8 Marsit 2014.

Vizita zyrtare e Komisionit për Politikën e Jashtme në Bullgari, 11–13 mars 2014.

Vizita zyrtare e Komisionit për Politikën e Jashtme në Kosovë, 13–15 prill 2014.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*IX Meeting of the conference of the European Integration/affairs committees of states participating in the Stabilisation and Association Process of the South Eastern Europe – COSAP*”, Beëiaëi, Montenegro, 20–23 qershor 2014.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*Annual meeting of Regional Parliamentary Defence and Security Committees*”, 4–6 qershor 2014, RACVIAC and Croatian Parliament.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*XVI Cetinje Parliamentary Forum, Women in Business*”, 8–10 qershor 2014, Cetinjë.

Pjesëmarrja e kryetares së Komisionit për Politikën e Jashtme në takimin e komisioneve të jashtme të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga Senati i Rumanisë, 17–18 qershor 2014.

Vizita e deputetes Valentina Leskaj në Gana dhe në Bregun e Fildishtë në datat 10–16 gusht 2014.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*OSCE Code of Conduct on Politico - Military Aspects of Security: 20 Years Anniversary / Peer to peer Review Conference*”, Zagreb, 30 shtator–2 tetor 2014.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*Organization for Economic Cooperation and Development/Development Assistance Committee (OECD/DAC), Peer Review of Italy, Field Visit to Albania*”, 21–25 tetor 2014.

Pjesëmarrja e delegacionit parlamentar shqiptar në “*World Bank/IMF Annual Meetings, The Parliamentary Network delegation*” në Uashington, 7–10 tetor 2014.

Një grup deputetësh të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, kryesuar nga z. Alfred Peza, nënkryetar i Komisionit, më 21–23 dhjetor 2014 zhvilloi një vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë me ftesë të nënkryetarit të parlamentit të Maqedonisë, z. Rafiz Aliti.

Në përbërje të delegacionit ishin deputetët Alfred Peza, Fatmir Toçi, Mimoza Hafizi dhe Astrit Veliaj.



## **Veprimtaria e Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë për vitin 2014**

Ky Shërbim drejton, koordinon dhe kontrollon veprimtarinë e marrëdhënieve me jashtë të Kuvendit të Shqipërisë dhe bashkëpunon me kabinetin e Kryetarit, Ministrinë e Punëve të Jashtme, trupin diplomatik të akredituar në Shqipëri dhe trupin diplomatik shqiptar të akredituar jashtë si dhe shërbimet e tjera të Kuvendit për mbarëvajtjen dhe realizimin e kësaj veprimtarie. Në përbërjen e këtij Shërbimi është dhe ai i Protokollit i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kjo është struktura e ngarkuar me detyrën e zbatimit të ceremonialit të brendshëm të këtij institucioni, aktivitetit parlamentar dhe rregullimin e aspekteve të ndryshme të marrëdhënieve me trupin diplomatik, marrëdhënieve publike të institucionit dhe takimet e parlamentarëve me delegacionet e huaja (VKM nr. 229, datë 23.04.2004, “Fletore zyrtare” nr. 29, datë 14.05.2004). Po ashtu në përbërje të këtij Shërbimi është dhe Njësia e Përkthimit, e cila e ushtron detyrën e saj në shërbim të veprimtarisë ndërkombëtare të institucionit





## Kapitulli 5

# TRANSPARENCA PARLAMENTARE

### PARLAMENTI DHE PUBLIKU

Vizioni për një parlament transparent bazohet në parimin e reflektimit të perspektivës qytetare gjatë gjithë veprimtarisë parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2014 pati një përqendrim të dallueshëm në dy drejtime: rritjen e perceptimit për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin; rritjen e perceptimit për një parlament të hapur dhe të vullnetshëm për të dhënë informacion.

Cilët janë hapat e hedhur?

Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës së Kuvendit është një burim për të nxitur dhe siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në funksionin legjislativ dhe atë mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë. Ai synon t'u japë mundësinë qytetarëve dhe organizatave jofitimprurëse të shndërrohen në pjesëmarrës aktivë të zhvillimit të komunitetit ku bëjnë pjesë dhe në kontribues të përmirësimit të politikave ligjore nga të cilat preken. Faza e parë procesit ishte hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të “Manualit për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje”, me ftesën për mendime e sugjerime. Faza e dytë e procesit drejt miratimit u përbë nga zhvillimi i tryezave konsultative me subjektet e interesuara, objekt i veprimtarisë së këtij projektmanuali. Manuali u miratua nga Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 17, datë 11.11.2014 dhe ekziston së bashku me një përmbledhje udhëzuese të tij në faqen zyrtare të internetit: [www.parlament.al](http://www.parlament.al).

Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Regjistrimit të Shoqërisë Civile, i shoqëruar me ftesën për regjistrime të reja sipas kriterëve të mirëpërcaktuara: numrin e NIPT-it, emërtimin e plotë të subjektit, të dhënat e personit të kontaktit apo të administratorit, adresën postare dhe elektronike, objektin e veprimtarisë. Për përditësimin e Regjistrimit është ngarkuar koordinatori për marrëdhëniet me shoqërinë civile në Kuvendin e Shqipërisë. Regjistri do të shërbejë si një instrument i forcimit të kontakteve dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile në kuadër të transparencës parlamentare, por dhe të rolit të OSHC-ve në dhënien e mendimit dhe të përvojës së nevojshme për të sjellë ndryshime pozitive në fushat apo çështjet për të cilat pritet vendimmarrje.

Transparenca institucionale e Kuvendit është përmirësuar dukshëm pas miratimit të dy rregulloreve të rëndësishme: *Rregullorja për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Rregullorja për funksionimin e faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet. Rregullorja për funksionimin e faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet* parashikon publikimin në faqen zyrtare të internetit: tekstin e projektligjeve të depozituara së bashku me relacionin shoqëruar të tyre menjëherë pas njoftimit në seancë plenare; kalendarin e punës së komisioneve të përhershme parlamentare menjëherë pas miratimit dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve; procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave; tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre; raportet e komisioneve parlamentare që shqyrtojnë projektligjin; ligjet e miratuara; njoftimet për veprimtarinë parlamentare;



informacione të përgjithshme: statistika, jetëshkrime, galeri videosh, galeri fotografish, struktura e administratës, njoftime për vende pune, për prokurime publike etj.

Gjatë vitit 2014 ka vijuar punën sektori i pritjes së popullit, trajtimit të letrave dhe peticioneve, i cili ka rritur efikasitetin në punën e tij, duke trajtuar të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në kohën më të shkurtër të mundshme, përmes angazhimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimin edhe me institucionet e tjera, si aktorë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës dhe të zgjidhjes së problemeve, duke u bazuar në fuqinë që paraqet ligji. Çdokush pritet, dëgjohet me kujdes dhe ndihmohet aty ku është e mundur, apo këshillohet, orientohet aty ku është e nevojshme. Me qëllim rritjen e transparencës dhe të përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve dhe të gjithë personave, çdo kërkesë të drejtuar sektori i përgjigjet me shkrim.

Gjithashtu është bashkërenduar puna me universitetet dhe drejtoritë arsimore për zbatimin e programeve për njohjen e veprimtarisë së Kuvendit me studentët dhe nxënësit.

#### ❖ Evidenca e shkresave sipas kategorive, periudha janar–dhjetor 2014

Nr	Muaji	Kartela	Kthim përgjigje	Fletëhyrje	Pritja e popullit
1	Janar	94	19	43	22
2	Shkurt	116	27	28	19
3	Mars	132	29	47	29
4	Prill	101	47	57	24
5	Maj	88	36	23	14
6	Qershor	78	27	15	16
7	Korrik	80	18	18	4
8	Gusht	23	17	0	0
9	Shtator	88	21	18	30
10	Tetor	57	33	7	27
11	Nëntor	67	15	231	8
12	Dhjetor	92	22	98	12
	<b>Gjithsej</b>	<b>1016</b>	<b>311</b>	<b>585</b>	<b>205</b>

#### ❖ Sipas problematikës dhe trajtimit të letrave situata ka qenë si më poshtë:

- 324 letra u përkasin problemeve të qytetarëve lidhur me pronësinë.
- 211 letra u përkasin kërkesave për punësim dhe ankesave për largim nga puna.
- 102 letra u përkasin ankesave lidhur me organet e rendit, organet gjyqësore, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe për zvarritjen e çështjeve hetimore e gjyqësore.
- 151 janë problematika lidhur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore.
- 74 letra lidhur me strehimin.
- 57 letra u përkasin ankesave për dëmshpërblimet e të dënuarve politikë.
- 33 letra janë kërkesa për ndihmë ekonomike.
- 30 letra janë kërkesa për fonde dhe mundësi bashkëpunimi ose propozime.
- 34 letra u përkasin shoqatave ose grupeve të qytetarëve që kanë ngritur probleme që kanë të bëjnë me komunitetet, me lagjet, fshatrat, komunat e bashkitë.



Për periudhën janar–dhjetor 2014 kanë vizituar mjediset e Kuvendit, gjithashtu edhe në galeri pranë sallës ku zhvillohen seancat parlamentare, shumë nxënës, studentë të shkollave dhe të universiteteve të ndryshme nga Shqipëria, Kosova, të cilët janë prezantuar në mënyrë dinjitoze dhe me profesionalizëm me organizimin, kompetencat, funksionimin, marrëdhëniet me institucionin dhe ato në varësi.

❖ **Evidenca e individëve dhe organizatave të shoqërisë civile në galeri dhe komisione:**

<b>Muaji</b>	<b>Galeri</b>	<b>Komisione</b>	<b>Gjithsej</b>
Prill	57	0	57
Maj	23	13	36
Qershor	11	8	19
Korrik	18	0	18
Shtator	4	14	18
Tetor	5	2	7
Nëntor	229	2	231
Dhjetor	98	0	98
Gjithsej	445	39	484
<b>Total</b>	<b>445</b>	<b>39</b>	<b>484</b>

## **PARLAMENTI DHE MEDIA**

“Rregullorja për akreditimin, akomodimin dhe orientimin e masmedieve pranë Kuvendit të Shqipërisë” (vendim i Byrosë së Kuvendit nr. 4, datë 12.02.2014) është publikuar edhe në faqen zyrtare në rubrikën “Shërbime për publikun”. Ajo parashikon jo vetëm mënyrën e akreditimit, akomodimin e masmedieve, sjelljen e tyre në mjediset e Kuvendit, por dhe garantimin e transparencës së punimeve në seancë plenare, në komisionet parlamentare, por dhe për veprimtaritë e tjera parlamentare. Gjatë vitit 2014 në Kuvendin e Shqipërisë janë të akredituar rreth 200 përfaqësues të medieve, përfshirë këtu edhe stafet që garantojnë mbështetjen teknike të transmetimeve.

Në mbështetje të transparencës së aktiviteteve të Kuvendit dhe të veprimtarisë legjislative në tërësi, ka ushtruar funksionin e tij Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun. Në ushtrimin e përditshëm të detyrës Shërbimi ka bashkëpunuar me medien për pasqyrimin e aktiviteteve parlamentare, duke ndjekur punën në seancë plenare si dhe procedurat për pasqyrimin e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit të Kryetarit të Kuvendit, por dhe të organeve të tjera të Kuvendit. Në vijim është bërë monitorimi i medias vizive dhe të shkruar lidhur me saktësinë dhe cilësinë informative. Janë organizuar në kohë dhe është koordinuar puna me medien për zhvillimin e konferencave për shtyp të Kryetarit të Kuvendit dhe deputetët, apo përfaqësues të organeve të Kuvendit sipas kërkesave të tyre.


Në çdo rast Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun ka garantuar komunikimin me medien lidhur me projektligjet që depozitohen në Kuvend, relacionet, kërkesat apo dokumente të ndryshme, duke koordinuar punën me sektorët e tjerë.

Gjithsej janë publikuar 738 materiale informuese për veprimtarinë parlamentare, produkte të sektorit të medias dhe internetit. Bashkëlidhur tyre janë përgatitur dhe fotografitë ilustruese. Sa i përket aktualitetit, materialet janë përkthyer në kohë reale në gjuhën angleze dhe janë publikuar po ashtu në seksionin anglisht në faqen zyrtare të internetit nga personi përgjegjës në Shërbimin e Marrëdhënieve me Publikun.



E gjithë kjo veprimtari, e cila është pasqyruar në mënyrë të rregullt në faqen zyrtare të internetit, është arkivuar sipas rregulloreve në zbatim.

❖ *Paraqitja grafike e materialeve informuese gjatë vitit 2014:*



Konferenca Kryetareve	Njoftim per shtyp
Takime te Nen/Kryetarit z.Vangjel Dule	Intervista te Kryetarit z.Illir Meta
Konferenca per shtyp te Kryetarit z.Illir Meta	Mbledhjet e Byrose
Komisioni per Reformen Territoriale	Komisioni Hetimor per Levizjet ne polici
Komisioni Hetimor per Forcat e Armatosura	Aktivitete te grupeve te miqesise
Aktiviteti I Aleances se Grave Deputete	Keshilli per Rregullores, Mandatin dhe Imunitetin
Komisioni per shkark e 2 anetareve te KLD-SE	Nenkomision per te drejtat e njeriut
AGD	Komisioni I posacem per Ref ne Drejtesi

## **KËRKIMI PARLAMENTAR DHE BOTIMET**

Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka siguron një gamë të gjerë informacioni për deputetët dhe stafin e tyre mbështetës nëpërmjet ofrimit të shërbimit të referencës së periodikut, librit, dokumentacionit parlamentar dhe bazave të të dhënave që ai disponon, me qëllim mbështetjen e tyre përmes informacionit për realizimin e detyrave gjatë procesit legjislativ dhe përfaqësues.

*Shërbimi i Kërkimit Parlamentar* realizon përgatitjen e materialeve kërkimore (informuese dhe/ose krahasuese) në bazë të kërkesave të ardhura ose me iniciativën e tij.

Referuar projektligjeve të ardhura në Kuvend, çështjeve të ndryshme, që në mënyrë të veçantë mund të bëhen objekt diskutimesh në mbledhjet e komisioneve ose ndihmojnë në mënyrë të përgjithshme veprimtarinë parlamentare, është parë e arsyeshme të përgatiten materiale informuese ose të jepen modele të ndryshme ligjesh për deputetët dhe stafin e komisionit.

Ky Shërbim gjatë vitit 2014 ka punuar materialet kërkimore për komisionet parlamentare, 45 sipas kërkesave të marra, 32 të punuara me iniciativë dhe 36 të tjera. Gjithsej 113 materiale.

Në krahasim me vitin 2013, kur ka pasur vetëm 4 kërkesa, ka një rritje të dukshme të kërkesave për Shërbimin e Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekën.



❖ **Bashkëpunimi me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar**


<b>Muaji</b>	<b>Kërkesat e ardhura</b>	<b>Kthim përgjigje</b>
Janar	7	7
Shkurt	6	6
Mars	5	5
Prill	10	10
Maj	5	5
Qershor	7	3
Korrik	3	3
Gusht	2	2
Shtator	8	8
Tetor	6	6
Nëntor	10	10
Dhjetor	10	5
<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>71</b>

❖ Nga korrespondenca me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar (ECPRD) u realizuan 11 produkte kërkimore. Përgjigjet e dhëna për ECPRD-në janë në rritje të dukshme në krahasim me vitin 2013, kur ka pasur vetëm 23 të tilla.


Nëpërmjet një korrespondence të frytshme gjatë vitit 2014 u realizua edhe anëtarësimi i Kuvendit në platformën *IPEX*, një platformë shumë e favorshme për shkëmbimin e bazës ligjore ndërmjet gjithë parlamenteve europiane.

**Shërbimi i Bibliotekës dhe Periodikut:**


Paraqitja grafike mbi fushat më të kërkuara



## Paraqitja grafike e frekuentuesve



## Frekuentuesit sipas muajve



Fondi i librave është pasuruar me 378 tituj të huazuar dhe 376 tituj të kthyer. Numri i përdoruesve është 70, të cilët e kanë frekuentuar bibliotekën 387 herë. Numri i përdoruesve të jashtëm është 4. Gjatë vitit 2014 u realizua për botim revista “Kuvendi” në dy numra të saj, që përfshijnë harkun kohor shtator 2013–shtator 2014. Synohet që në vijimësi të ruhet jo vetëm struktura tashmë e prezantuar në dy numrat e parë të revistës, por të ketë një larmi problematikash të trajtuara, si dhe rritja e cilësisë së publikimeve në numrat në vijim. Qëllimi është që përmes publikimeve thellësisht përmbajtësore kjo revistë të kthehet në një burim reference për studiues, akademikë, hulumtues, publikun e gjerë dhe për gjithë të interesuarit brenda dhe jashtë Shqipërisë lidhur me veprimtarinë e Kuvendit. Për këtë qëllim u propozua dhe u punua në drejtim të ngritjes së një bordi këshillimor për revistën.

Janë përgatitur për botim kolana “Punimet e Kuvendit” për vitin 2013 në pesë vëllime. Gjithashtu nga Sektori i Botimeve Parlamentare janë realizuar ideime dhe realizime të kopertinave cilësore të botimeve për vitin 2014–2015, të banerave, ftesave, kartolinave, fletëpalosjeve etj. Shërbimi ka kontribuar mjaft në realizimin e veprimtarive me tematikë historike dhe sociale.

Sektori i Redaktorëve gjatë vitit 2014 ka punuar për zbardhjen dhe redaktimin e seancave plenare, të komisioneve të përhershme, të përkohshme e të posaçme parlamentare dhe redaktimin e mbledhjeve



të Konferencës së Kryetarëve dhe të Byrosë Parlamentare. Në saje të angazhimit të të gjithë punonjësve të Sektorit të gjitha seancat plenare janë zbardhur dhe u janë vënë në dispozicion deputetëve në kohën e përcaktuar nga Rregullorja e Kuvendit.

Të gjitha procesverbalet e seancave plenare janë dorëzuar në seancën pasardhëse dhe pas miratimit të tyre në seancë janë pasqyruar në mënyrë të përpiktë në faqen e internetit të Kuvendit, duke pasur gjithnjë parasysh që të reflektohen me kujdes edhe vërejtjet dhe saktësimet e bëra nga deputetë të veçantë. Ndërsa komisionet parlamentare, me gjithë impenjimin e plotë të të gjithë sektorit, për shkak të numrit të madh të mbledhjeve të zhvilluara dhe të orëve të zgjatura të mbledhjeve të komisioneve, disa herë nuk është arritur të dorëzohen në mbledhjen pasardhëse, siç e përcakton Rregullorja e Kuvendit.

Gjatë këtij viti nga Sektori i Redaktorëve janë zbardhur, redaktuar dhe hedhur në faqen e internetit 41 seanca plenare, me një total prej 11485 minutash, të cilat janë pasqyruar në 2167 faqe (me gërmë 10-she pa spacio).

Gjithashtu nga Sektori i Redaktorëve janë zbardhur dhe redaktuar 587 mbledhje të komisioneve, me një total prej 33099 minutash, që u korrespondojnë 13889 faqeve me gërmë 12-she me spacio.

## TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Prej muajit shtator 2014 të gjithë të interesuarit për punimet e Kuvendit të Shqipërisë dhe vizitorët në mjediset e Kryesisë së Kuvendit dhe në Sallën e Seancave Plenare do të kenë mundësinë të marrin një informacion elektronik të shpejtë e mjaft të dobishëm, orientues, të përditësuar e transparent përmes dy pikave të informimit *Info Point* të vendosura respektivisht në këto ambiente.

Ky sistem informimi është produkt i bashkëpunimit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili përmes Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit ka zhvilluar pjesën softuere të *Info Point*-it, dhe OSBE-së, e cila i është përgjigjur vullnetit të mirë të institucionit, duke u bërë donatore e pajisjeve harduere të këtij sistemi informimi. Sistemi *Info Point* vlerësohet jo vetëm për rëndësinë që ka për modernizimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në Kuvendin e Shqipërisë, por dhe për domethënien dhe funksionalitetin e tij në shërbim të interesit për një informacion të saktë për publikun, gazetarët dhe të gjithë vizitorët që dëshirojnë të ndjekin punimet e Kuvendit, po ashtu dhe për deputetët dhe punonjës të administratës. Me këtë vizion është zhvilluar programimi dhe dizenjimi i këtij sistemi informativ, i cili përmban ndër të tjera informacionet kryesore mbi vendin, orën, rendin e ditës të punimeve të Kuvendit.

Përmes punës së Shërbimit të IT-së janë aktivizuar të gjitha shërbimet e platformës *e-parliament*. Në funksion të kësaj platforme është ngritur dhe një grup pune. Është bërë trajnimi i stafit të IT-së prej specialistëve të firmës “Nextsense”, që ka zhvilluar sistemin, po ashtu me asistencën dhe të stafit të IT-së janë zhvilluar trajnime të të gjithë administratës së Kuvendit. Këto trajnime do të vijojnë me stafin joteknik për përdorimin e kësaj teknologjie të re për Kuvendin dhe stafin e tij. Funksionaliteti i kësaj platforme është në varësi dhe të faktorëve humanë dhe teknikë, por shërbimi i IT-së ka angazhimin maksimal për profesionalizimin e tij, të administratës dhe të deputetëve në drejtim të vënies plotësisht në zbatim të kësaj platforme, e cila vlerësohet shumë e rëndësishme për qasjen në botën dixhitale, në lehtësimin e detyrave funksionale të përditshme si të stafit, ashtu dhe të deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë.

Një tjetër arritje në fushën e informatizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës elektronike në Kuvend është dhe informatizimi i ordinatorëve dhe investimi në pajisje të reja rrjeti. Në kuadër të avancimit teknologjik dhe kalimin në përdorimin e teknologjive dixhitale për kryerjen e detyrave të përditshme prej stafit të administratës dhe deputetëve janë marrë disa vendime të rëndësishme në drejtim të investimit në harduer. Është vendosur zëvendësimi i ordinatorëve të vjetër me ordinatorë të rinj, duke mundësuar gjithashtu përdorimin e programeve të licensuara. Standardizimi i nivelit të aksesëve prej përdoruesve joteknikë, standardizimi i aplikacioneve të përdorura, licensimi i aplikacioneve të përdorura



janë hapa të rëndësishëm.

Është bërë investimi në disa pajisje të rrjetit kompjuterik, si: pajisje *wireless*, *firewall* etj., të cilat janë të rëndësishme në kuadër të vizionit të IT-së për këtë legjislaturë, për transformimin krejtësisht të punës në mënyrë të dixhitalizuar dhe elektronike, aq më tepër për sa i përket përdorimit të platformës *e-parliament*.

Gjatë vitit 2014 është bërë një përpjekje serioze për ndërtimin e faqes së re të internetit, duke përdorur resurset e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit. Për këtë u është referuar standardeve dhe praktikave më të mira europiane si dhe rekomandimeve IPA. Funksionimi i plotë i kësaj faqeje të integruar me *e-parliament* është një ndër objektivat më parësorë për vitin 2015 të Shërbimit.





## Kapitulli 6

### SHËRBIMI ADMINISTRATIV

#### FINANCA DHE BUXHETI

Nën drejtimin dhe përgjegjësinë e Shërbimit Administrativ gjatë vitit 2014 është hartuar dokumenti i PBA-së 2015–2017 në dy fazat që parashikon kuadri ligjor në fuqi, duke e përcjell në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet buxhetore. Ky dokument është një përmbledhje e vlerësimit të nevojave nga të gjitha shërbimet e Kuvendit, me qëllim realizimin e objektivave të secilit shërbim. Në zbatim të nenit 10 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit, projektbuxheti i është bërë me dije paraprakisht Sekretariatit për Buxhetin dhe Byrosë së Kuvendit, duke e shoqëruar me analizën dhe argumentet përkatëse.

#### b. Synimet kryesore të buxhetit

- ◆ Rritja e efektivitetit në menaxhimin e shpenzimeve publike.
- ◆ Mundësimi i plotësimit të nevojave buxhetore në realizimin e politikave të programeve.
- ◆ Përfshirja e të gjithë menaxherëve të lartë të institucionit në procesin e vlerësimit të nevojave dhe në zbatimin e buxhetit.
- ◆ Orientimi i shpenzimeve në ato drejtime që vlerësohen si prioritete për politikën e programit.

#### c. Realizimi i buxhetit

Gjatë vitit 2014 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit administroi dhe menaxhoi fondet publike, ndarë në dy programe buxhetore: atë të veprimtarisë legjislative dhe planifikimit, menaxhimit dhe administrimit

Emërtimi I projektit <sup>2</sup>	Llogaria ekonomike	Programi legjislativ		Programi administrativ	
		Programuar	Realizuar	Programuar	Realizuar
1	2	3	4	5	6
Pagat	6000000	302.000.000	269.492.819	218.000.000	170.421.524
Kontributi i sigurimeve shoqërore	6010000	45.000.000	31.233.712	35.000.000	29.371.680
Mallra dhe shërbime	6020000	261.500.000	228.780.908	81.000.000	68.202.205
Transferta korrente të huaja	6050000	12.000.000	9.796.492		
Transferta korrente për buxhetet familjare	6060000			25.000.000	20.087.237
Investime kapitale	2310000			52.500.000	
<b>Totali</b>		<b>620.500.000</b>	<b>539.303.931</b>	<b>411 500 000</b>	<b>340582646</b>


<sup>2</sup>Tabela e mësipërme pasqyron planin buxhetor vjetore me ndryshimet e bëra gjatë vitit, duke marrë parasysh dhe aktin normativ nr. 1 të qeverisë.



Gjatë vitit 2014, si rezultat i rivlerësimeve që u bënë nga shërbimet për nevojat, por dhe për probleme në procedura prokurimi, janë kthyer fonde në buxhet, të cilat janë reflektuar me aktin normativ nr. 2, dhjetor 2014.

### **Zëri i pagave (artikulli 600) është realizuar në masën 85%**

Fondi i pagave përbëhet nga fondi i pagave për deputetët, stafin politik dhe stafin administrativ, mbështetës. Realizimi faktik i fondit të pagave për secilin program paraqitet në grafikun e mposhtëm:



Në listëpagesat e pagave janë ndaluar me korrektësi kontributet e punëmarrësve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe ato suplementare, si dhe tatimi mbi të ardhurat nga paga sipas legjislacionit në fuqi.

Transferimi i pagave në llogaritë bankare për punonjësit e deputetët bëhet në 11 banka të nivelit të dytë. Njoftimet për kreditimin në llogari bëhen nëpërmjet adresave elektronike të punonjësve dhe deputetëve.

Gjatë vitit 2014 jo të gjithë ministrat dorëzuan menjëherë mandatin e deputetit, kjo u realizua gradualisht dhe, meqenëse ministrat paguhen në ministratë përkatëse, fondi i akorduar për ta si deputetë kthehet në buxhetin e shtetit. Vendimi i Kuvendit nr. 63/2013 penalizon deputetët që nuk marrin pjesë në aktivitete parlamentare (seanca plenare dhe komisione të përhershme parlamentare) me vlerën e pagës ditore kur mospjesëmarrja nuk ka shkaqe të ligjshme.

Nuk janë realizuar procedurat e konkurrimit për të gjithë strukturën e burimeve njerëzore, numri faktik i punonjësve ka qenë më i ulët se numri i miratuar në ligjin vjetor të buxhetit.

### **Shpenzimet për sigurime shoqërore (analiza 601)**

Fondi i akorduar për vitin 2014 ishte 80 milionë lekë, ndërsa realizimi faktik 61 milionë lekë, pra 76%.


Duke qenë se fondi i sigurimit është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, shkaqet e mosrealizimit të fondit të pagave vlejné dhe për këtë zë, por duhet të theksojmë se gjatë vitit ushtrimor shumë punonjës paguhen për aftësi të përkohshme në punë rast pas rasti dhe për këtë periudhë nuk paguhen kontribute. Shërbimi i Financës ka deklaruar *online* në sistemin tatimor kontributet për secilin punonjës dhe deputet, duke referuar numrin e sigurimit shoqëror për secilin, si dhe ka transferuar pagesat e këtyre kontributeve, duke respektuar afatet ligjore.



## Shpenzimet operative (artikulli 602)

Që në fillim të vitit buxhetor u bë ndarja e buxhetit sipas nevojave të shërbimeve dhe prioriteteve dhe mbi këtë bazë, në bashkëpunim me Shërbimin e Prokurimit, u hartua regjistri i prokurimeve.

Grafiku paraqet realizimin plan-fakt për secilin program buxhetor, ndërsa totali i këtij zëri është realizuar në masën 87.6%.



Ky zë përfshin një gamë të gjerë shërbimesh të domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit dhe realizimin e objektivave të të gjitha shërbimeve.


Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2014 Shërbimi i Financës ka zbatuar udhëzimin nr. 3, datë 17.01.2014.

Çdo urdhër prokurimi është dërguar në degën e thesarit për miratim përpara ekzekutimit, sikundër çdo kontratë e nënshkruar me të tretë është regjistruar në buxhet për të ngurtësuar angazhimet në vlerën e saj, me qëllim moslejimin e ndërrimit të destinacionit të fondeve dhe krijimin e debitorëve.

Në këtë zë buxhetor përfshihen përfitimet ligjore të deputetëve, si: kompensime për telefoninë, për karburant, honorare për pjesëmarrje në komisione parlamentare, dietat brenda vendit, kompensim për qira banese për ata deputetë që përfitojnë etj. Mbështetur në kuadrin ligjor për trajtimin e deputetëve, përfitimet llogariten në vlerën 200 milionë lekë, që përbejnë rreth 60% të shpenzimeve operative 602. Realizimi faktik, i cili është gjithmonë më i ulët, pasi honoraret varen nga numri i komisioneve që zhvillohen gjatë vitit, vlera e dietave varet nga numri i ditëve të shërbimeve brenda vendit që raportojnë deputetët. Për vitin 2014 ishte 160 milionë lekë, ose 53% e shpenzimeve totale 602.

Gjithashtu Shërbimi i Financës ka ndjekur dhe kontribuar në hartimin e gjurmëve të auditimit, duke iu përgjigjur urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave lidhur me procedurat me blerje të vogël dhe të lartë të prokurimeve.

## Grafiku i shpenzimeve kryesore që bëjnë pjesë në këtë zë buxhetor




Edhe në programin administrativ nuk u realizuan shpenzimet operative, dhe kjo për arsye se:



- U kërkuan nga Shërbimi IT-së 10 milionë lekë për mirëmbajtjen e sistemit elektronik të votimit dhe shërbimin e fotokopjeve së bashku. Nga këto u realizuan 4 milionë lekë.
- U kërkuan 5 milionë lekë shtyshkrime nga shërbimi përkatës, nga të cilat u realizuan 1.7 milion lekë. Nuk u realizuan fondet për blerjen e pjesëve të këmbimit, pasi u anuluan kontratat e lidhura me operatorët për mosplotësim specifikimesh teknike.

**Përdorimi i fondit të veçantë.** Është përdorur për ndihmë ekonomike në raste sëmundje të rënda dhe fatkeqësi në familje 40 000 lekë dhe një pagë mujore për dalje në pension.

Për të gjitha këto shpenzime janë ndjekur procedura prokurimi, kryesisht *online*, përveç shërbimeve protokollare, të cilat përjashtohen nga prokurimi *online*.

*Diagramet e mposhtme japin trendin e disa grup-shpenzimeve që realizohen gjatë një viti:*





Siç shihet nga diagramet, shpenzimet utilitare janë në rënie. Këtu ka ndikuar ulja e shpenzimeve telefonike, si telefonia fikse, ashtu dhe ajo celulare. Për telefoninë celulare nuk u arrit lidhja e kontratës me operatorët mobile.

Shpenzimet e pritjes dhe ato të udhëtimeve jashtë shtetit janë në rritje, pasi është shtuar numri i delegacioneve të huaja në Shqipëri, por dhe numri i aktiviteteve ndërparlamentare në të cilat Shqipëria përfaqësohet.

Gjatë vitit 2014 kanë udhëtuar 86 delegacione parlamentare, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 215 pjesëmarrës (deputetë) dhe kanë qëndruar jashtë shtetit 699 net.

### **Investimet kapitale (artikulli 230-231)**

Siç e kemi parë dhe në pasqyrën që tregon buxhetin e vitit 2014, fondet për investime kapitale janë miratuar në vlerën 52.5 milionë lekë (duke pasur parasysh ndryshimet e kërkuara gjatë vitit nga institucioni ynë), nga të cilat janë realizuar 82%.



230	M020022	Proj. realiz. sist. sigurisë	500	446.4
230	M020001	Proj. rikon. godine	2,100	193.2
231	M020002	Blerje pajisje zyrash	29,000	26674
231	M020004	Blerje autoveturë	8,000	7,733
231	M020023	Sistem i autom. kab. elektrike	1,400	1352
231	M020019	Pajisje për zyrat zgjedhore	3,500	3468
231	M020021	Siguri optim. rrjeti i Kuvendit	8,000	3265

Çdo kontratë e nënshkruar pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe shpalljes së ofertës fituese është mbikëqyrur nga grupi i punës i ngritur për këtë problem, duke kontrolluar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të kërkuara nga institucioni.

Shërbimi i Financës ka mbajtur 5% të vlerës së investimeve, duke e transferuar atë në llogarinë buxhetore “mjete monetare në ruajtje”, të trashëgueshme, deri në përfundimin e periudhës së garancisë.

Një ndër projektet e investimeve ishte dhe mobilimi i zyrave zgjedhore, që u ndoq nga grupi i punës deri në montimin e pajisjeve në 12 zyra zgjedhore në ato qarqe që kanë vënë në dispozicion hapësirat.

Projekti i optimizimit të rrjetit është realizuar pjesërisht, ndërsa në detajimin e fondit të investimeve për vitin 2015 është pasur parasysh përfshirja e pjesës së papërfunduar brenda datës 31.12.2014 të këtij projekti (vlera 4.5 milionë lekë).

### **Menaxhimi i aktiveve në institucion**

Në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH-ja, ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, grupi i punës i ngritur nga Sekretarja e Përgjithshme me nr. 6, datë 6.11.2013, në të cilin Shërbimi i Financës ka pasur përfaqësuesit e tij, ka dorëzuar një set procedurash, si:

- Urdhër nr. 2, datë 30.01.2014 për miratimin e rregullores për menaxhimin e aktiveve në institucion dhe rregulloren bashkëlidhur.
- Urdhër nr. 3, datë 30.01.2014 mbi kërkesat për shpenzime/prokurime me vlerë të lartë dhe atë për prokurime me vlera nën kufirin e ulët monetar.
- Listën e proceseve të punës për këto prokurime dhe diagramin përkatës.

Me nr. 1906 prot., datë 30.05.2014, Sekretarja e Përgjithshme ngriti grupin e punës për vlerësimin e aktiveve të dhuruara në institucion, të cilat ishin të kontabilizuara me vlerë 1 (një) lek, për t’u bërë pjesë e regjistrit të aktiveve dhe për t’u ndjekur menaxhimi i tyre për të mos lejuar humbjen, vjedhjen, keqpërdorimin.

Me nr. 1906/2, datë 23.07.2014, grupi i punës ka dorëzuar vlerësimin, i cili është pasuar me veprimin e kontabilizimit të vlerave në kontabilitet.

Janë ngritur grupe pune për vlerësimin e aktiveve që nga procesi i inventarizimit të bërë në vitin 2013 rezultuan jashtë funksionit, si dhe për ato autovetura që ishin jashtë funksionit, krejtësisht të amortizuara, të rezultuara pa shitur dhe pa u marrë në dorëzim nga Rezervat e Shtetit dhe të çregjistruara në organet përkatëse.

Ka përfunduar procesi i zëvendësimit të të gjithë kompjuterave të përdorur me kompjutera të rinj, me qëllim përshtatjen në parametra me sistemin *e-parliament* dhe janë mbledhur të gjithë kompjuterat e përdorur. Ky proces u pasua nga procesi i formatimit të kompjuterave nga Shërbimi i IT-së dhe do të kalohet në fazën e transferimit në institucione të tjera buxhetore.



## PROKURIMET

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2014, në zbatim të rregullave të prokurimit publik, Sektori i Prokurimeve përgatiti regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike. Ky regjistër u dërgua për botim në Agjencinë e Prokurimit sipas afateve të përcaktuara në legjislacion. Pas botimit të regjistrit të parashikimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik, Sektori i Prokurimeve, në bashkëpunim me drejtoritë e linjës, filloi punën për plotësimin e dokumentacionit për shpalljen e procedurave. Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve u publikua edhe në faqen e internetit të Kuvendit. Të gjitha procedurat standarde të prokurimit u zhvilluan me mjete elektronike nëpërmjet sistemit *online*.

Gjatë vitit 2014 në Kuvendin e Shqipërisë janë shpallur gjithsej 27 procedura prokurimi me blerje të mëdha dhe 41 procedura me blerje të vogla. Blerja e biletave të transportit jashtë vendit është kryer me procedurë me blerje të vogël. Gjithsej janë bërë rreth 200 të tilla nga komisioni i blerjeve të vogla. Fondi limit i parashikuar për këto procedura ka qenë 141 954 083 lekë (me TVSH), nga të cilat 51 340 000 lekë ishin fonde investimesh dhe 90 614 083 lekë ishin procedura me fondet e shpenzimeve operative.

Pas ndryshimeve në planin e investimeve vijuan procedurat si më poshtë:

- ◆ Me fondet e investimeve u realizuan 17 procedura prokurimi, nga të cilat 6 procedura me blerje të mëdha dhe 11 procedura me blerje të vogla.
- ◆ Me fondet e shpenzimeve operative u realizuan 51 procedura prokurimi, nga të cilat 20 janë procedura me blerje të mëdha dhe 31 janë procedura me blerje të vogla, pa llogaritur procedurën e blerjes së biletave të transportit ajror.
- ◆ Si rezultat i konkurrencës, u arrit që në përfundim të procedurave të kishte një efekt ekonomik pozitiv ndaj fondit limit.
- ◆ Të gjitha procedurat e prokurimit të planifikuara për vitin 2014 përfunduan brenda afatit të përcaktuar në rregullat e prokurimit, pra para datës 31 dhjetor.

Gjatë vitit 2014 nuk u arrit të realizohej vetëm procedura me objekt shërbimi i telefonisë celulare, për shkak se operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk plotësuan kërkesat e kërkuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor. Kjo procedurë u krye tri herë sipas ligjeve të prokurimit publik në fuqi, por nuk u paraqit asnjë ofertë e vlefshme dhe, për rrjedhojë, nuk pati ofertë fituese.

Dy procedurat e prokurimit që u zhvilluan nga Sektori i Prokurimeve, përkatësisht blerje pjesësh këmbimi për autovetura me dy lote dhe blerje gomash për automjete, për të cilat u lidhën dhe kontratat përkatëse, nuk u realizuan, pasi operatorët ekonomikë nuk plotësuan specifikimet teknike që kishin paraqitur në ofertë. Kjo bëri që autoriteti kontraktor të zgjidhte kontratën me këta operatorë.

## TRANSPORTI

Shërbimi i Transportit, mbështetur në *Manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit të Shqipërisë*, është angazhuar për përmbushjen sa më mirë të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në këtë manual.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, për t'i ofruar Kuvendit të Shqipërisë shërbime transporti cilësore dhe në kohën e duhur, u hartua plani vjetor i shpenzimeve për këtë Shërbim për vitin 2014, duke bërë dhe ndarjen në zëra të veçantë. Bazuar në këtë ndarje, u hartua dhe tabela përkatëse me fondet financiare, afatet kohore të blerjes së mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Shërbimin e Transportit, që shërbeu si bazë për hartimin e regjistrit të prokurimeve të institucionit për vitin 2014.



## SHËRBIME TË TJERA ADMINISTRATIVE

**Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimet të Deputetëve**, në mbështetje të legjislacionit për Shërbimin Civil dhe vendimit nr. 2, datë 8.11.2013 të Byrosë së Kuvendit “Për strukturën e administratës së Kuvendit”, Shërbimi i Burimeve Njerëzore ka punuar për plotësimin e organikës së administratës së Kuvendit për të punësuar gjithsej 44 nëpunës, nga të cilët 4 nëpunës politikë, 37 në pozicione të Shërbimit Civil (15 të nivelit drejtues, 22 specialistë) dhe 3 nëpunës të thjeshtë. Plotësimi i vendeve të lira është bërë nëpërmjet emërimeve të përkohshme për disa pozicione emergjente (21). Këto emëime janë bërë në periudhën janar–26 shkurt 2014. Nga këta: 16 të rinj dhe 5 me ngritje në detyre, duke qenë nëpunës civil në Kuvend.

Mbështetur në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, gjatë periudhës janar–shkurt 2014 janë zhvilluar 8 konkurse pranimi në Shërbimin Civil për pozicione nga specialist deri drejtor i përgjithshëm, nëpërmjet të cilave u rekrutuan 20 nëpunës të rinj civilë, nga të cilët 18 me rekrutim dhe 2 me lëvizje paralele. U pezulluan 28 konkurse të shpallura në muajin dhjetor 2013 për shkak të rrëzimit nga Gjykata Kushtetuese të aktit normativ për ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me vendimin nr. 50, datë 24.04.2014 “Për planin vjetor të pranimeve në Shërbimin Civil të Kuvendit” nga 17 vende të lira u shpallën konkurse për 12 pozicione të nivelit ekzekutiv. Gjatë vitit 2014, pas publikimit të planit në portal, janë krijuar dhe 3 vende të reja nga dorëheqjet dhe largimet.

Në fund të vitit 2014 numri i përgjithshëm i punonjësve në administratën e Kuvendit, sipas strukturës, është 361. Në këtë numër përfshihen 140 deputetë dhe 221 nëpunës të administratës. Nga këta 28 janë nëpunës politikë, 144 janë nëpunës civilë të nivelit nga drejtor i përgjithshëm deri specialist dhe 49 punonjës të shërbimeve mbështetëse.

Numri i të punësuarve në fund të vitit 2014 ishte 349, nga të cilët 138 deputetë dhe 211 staf, nga të cilët: nëpunës politikë 26, nëpunës civilë 137 dhe nëpunës të thjeshtë 48.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në zbatim të nenit 67, pika 3 dhe 4, Shërbimi i Burimeve Njerëzore (njësia përgjegjëse) bëri deklarimin e statusit të punësimit për të gjithë nëpunësit civilë të administratës së Kuvendit, të rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”. Për 64 nëpunës u bë rikonfirmimi i statusit dhe për 7 nëpunës u bë akti i deklarimit të statusit të punësimit.

Në drejtim të **rritjes së kapaciteteve të administratës së Kuvendit** gjatë vitit 2014 kanë kryer trajnimin e detyruar “Prezantimi me administratën publike” pranë ASPA-së 23 nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv dhe për 22 prej tyre vlerësimi ka qenë pozitiv, si një nga dy kushtet për marrjen e statusit të nëpunësit civil (tjetri është vlerësimi pozitiv i periudhës njëvjeçare në provë).

Kanë kryer trajnime pranë ASPA-së 15 nëpunës civilë të niveleve të ndryshme për tema të tjera, si: etika dhe konflikti i interesit në administratën publike, menaxhimi i politikave publike, mbrojtja e të dhënave personale, bazat e prokurimit publik, menaxhimi dhe kontrolli financiar, menaxhimi i ciklit të projektit, kontrolli financiar, risku etj.

Në bashkëpunim me OSBE-në në gusht 2014 u zhvillua seminari planifikues me nëpunësit e rinj të nivelit drejtues. Në të morën pjesë 18 nëpunës. Ky trajnim u financua nga OSBE-ja.

Për rritjen e kapaciteteve për ekspertizë ligjore gjatë vitit 2014 kanë marrë pjesë në trajnime jashtë vendit disa drejtorë, këshilltarë të fushave të ndryshme dhe specialistë për njohjen me praktikat parlamentare të BE-së. Gjatë vitit 2014 kanë marrë pjesë në tryeza e seminare dhe janë trajnuar jashtë Shqipërisë 27 nëpunës në vende të rajonit, në Parlamentin Europian dhe në Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shërbimi i Burimeve Njerëzore, sipas vendimit të Byrosë nr. 19, datë 11.11.2014 “Për hapjen e zyrave për deputetët në 12 qarqe”, në bashkëpunim me prefekturat në muajin dhjetor veproi për të siguruar ambiente të lira për 13 zyra në 8 qarqe, përkatësisht: në Fier 2 zyra, në Gjirokastrë 2 zyra, në





Kukës 2 zyra, në Korçë 2 zyra, në Shkodër 1 zyrë, në Berat 1 zyrë, në Elbasan 1 zyrë, në Durrës 1 zyrë. Njëkohësisht në muajin dhjetor janë blerë pajisjet për 23 zyra zgjedhore në rrethe. Në 12 prej tyre (zyrat e përmendur më sipër) janë shpërndarë pajisjet, ndërsa për 11 zyra pajisjet janë depozituar në magazinën e Kuvendit deri në gjetjen e zyrave të tjera për deputetët në prefekturat që mbeten. Specialisti dhe përgjegjësi për trajtimin e deputetëve kanë qenë pjesë e grupit të punës për ndjekjen e procedurave për blerjen e pajisjeve, si dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës së blerjeve, shpërndarjen në rrethe dhe hartimin e raportit përfundimtar.

Për deputetët që kanë marrë mandatin pas dorëheqjes së deputetëve-ministra, në bashkëpunim me OSBE-në, në datën 23 prill 2014 në mjediset e Kryesisë së Kuvendit u organizua takimi me temë: “Orientim për deputetët”. Qëllim i këtij takimi ishte njohja e deputetëve të rinj me shërbimet që ofron administrata e Kuvendit në funksion të veprimtarisë së tyre ligjvënëse.

Të pranishëm në këtë takim ishin z. Robert Uilton, zëvendësambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, dhe z. Edmond Spaho, nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 4 forume me deputetët e qarqeve Shkodër, Dibër, Gjirokastrë dhe Fier. Në të gjitha forumet e organizuara kemi evidentuar qartë rëndësinë e këtyre takimeve mes deputetëve dhe shoqërisë civile. Në pamundësi të takimeve periodike, për mungesë edhe të zyrave të deputetëve në rrethe, këto forume kanë mundësuar ballafaqimin konstruktiv të zgjedhësve me deputetët, ngritjen e problematikave specifike për çdo qark, si dhe sugjerimin ose angazhimin e deputetëve për zgjidhjen ose orientimin për zgjidhje të problemeve të komunitetit të qarkut ku janë zgjedhur.

Gjatë vitit 2014 **Zyra e Arkivit** ka vazhduar të përmbushë objektivat e punës së saj bazuar në detyrat e përcaktuara në *Manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit të Shqipërisë*, si dhe në përputhje me Rregulloren për administrimin e dokumentacionit parlamentar dhe funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar.

Ka vijuar puna me përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit parlamentar dhe administrativ, duke përfunduar ngritjen dhe automatizimin e inventareve përkatëse me afat ruajtje të përhershëm dhe të përkohshëm:

<i><b>Inventar i përhershëm 22/2012:</b></i>	<i><b>590 dosje</b></i>
<i><b>Inventar i përkohshëm 22/2012:</b></i>	<i><b>545 dosje</b></i>
<i><b>Inventar i përkohshëm 16/2006:</b></i>	<i><b>373 dosje</b></i>

Pas verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim nga Zyra e Protokollit (qershor 2014) të të gjithë dokumentacionit të krijuar gjatë veprimtarisë parlamentare dhe administrative të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2013, Zyra e Arkivit vijoi punën për përpunimin përfundimtar të tij, duke realizuar ngritjen e inventareve përkatëse.

<i><b>Inventar i përhershëm 23/2013:</b></i>	<i><b>576 dosje</b></i>
<i><b>Inventar i përkohshëm 23/2013:</b></i>	<i><b>420 dosje</b></i>

Me qëllim azhurnimin dhe rishikimin e fondit arkivor në vite, ka filluar puna në retrospektivë për fondet e atyre viteve që kërkojnë bërjen e shtesave brenda inventareve të tyre përkatëse, duke riklasifikuar dosjet ekzistuese dhe ato të reja dhe duke i unifikuar ato me bazën e përgjithshme të fondit arkivor të Kuvendit.

<i><b>Inventar i përhershëm 5/1995:</b></i>	<i><b>në proces</b></i>
<i><b>Inventar i përhershëm 14/2004:</b></i>	<i><b>449 dosje</b></i>
<i><b>Inventar i përhershëm 15/2005:</b></i>	<i><b>365 dosje</b></i>
<i><b>Inventar i përhershëm 19/2009:</b></i>	<i><b>536 dosje</b></i>



Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të institucionit të Avokatit të Prokurimeve për vitet 2007–2013, përfundoi procesi i inventarizimit dhe kalimi i këtij fondi pranë Arkivit të Kuvendit<sup>3</sup>.

Ka përfunduar procesi i marrjes në dorëzim të fondit arkivor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me afat ruajtje të përhershëm për vitet 1998–2005, shoqëruar me inventaret përkatëse.

Zyra e Arkivit gjatë këtij viti ka ofruar shërbimin e saj për realizimin në kohë dhe me efikasitet të rreth 360 kërkesave të ardhura nga shërbimet e administratës së Kuvendit, institucionet shtetërore dhe individë të veçantë. Duhet thënë se vihet re një rritje e ndjeshme e kërkesave që i kanë ardhur Sektorit të Arkivit si në rrugë fizike, ashtu dhe në kthimin e përgjigjeve me telefon apo me rrugë elektronike. Shërbimi është ofruar nëpërmjet dokumenteve origjinale ose riprodhimeve të tyre, vënies në dispozicion të përmbledhjeve me dokumente, inventareve apo bibliografive tematike për çështje të caktuara, dhënies së informacionit dhe burimeve të tij për problemet që u kanë interesuar personave kërkues.

---

<sup>3</sup>Dokumentacioni, që rezulton të ishte rreth 30 metra linear, u dorëzua i papërpunuar dhe pa asnjë inventar përkatës.



## Kapitulli 7

# PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2015

### OBJEKTIVI I: forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon masa që synojnë forcimin e shqyrtimit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me qëllim garantimin e përafrimit më efikas dhe me cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar. Gjithashtu parashikohet miratimi i Kodit të Sjelljes së Deputetëve, i cili përcakton parimet dhe standardet e sjelljes së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, me synim forcimin e besimit të zgjedhësve shqiptarë të përfaqësuesit e zgjedhur prej tyre dhe konsolidimin e mëtejshëm të vlerave demokratike dhe të parlamentarizmit në Shqipëri.

1. Rishikimi i ligjit nr. 9252, datë 8.07.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian”, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor të punës së Kuvendit në procesin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së.

2. Analizë mbi efektet që mund të sjellë rishikimi i ligjit nr. 9252, datë 8.07.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian”, në procedurat legjislative dhe bazën metodologjike të punës së Kuvendit në procesin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së.

3. Miratimi i Kodit të Sjelljes së Deputetëve.

### OBJEKTIVI II: forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit

Përveç masave që synojnë forcimin e rolit kontrollues të Kuvendit mbi veprimtarinë e qeverisë në përgjithësi dhe në çështjet e integritit europian në veçanti, kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon edhe masa që synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura, me qëllim garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre.

#### II.a. Forcimi i mëtejshëm i rolit mbikëqyrës të Kuvendit

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon 2 masa që synojnë forcimin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës të Kuvendit përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar, duke përfshirë ngritjen e komisioneve hetimore në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

1. Ushtrimi më sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë lidhur me zbatimin e ligjeve dhe të politikave përmes:

- përdorimit më intensiv të interpelancave, pyetjeve me shkrim dhe me gojë;
- publikimit në faqen e internetit të Kuvendit të pyetjeve me shkrim të bëra nga deputetët dhe të përgjigjeve me shkrim të dhëna nga qeveria, sipas nenit 94 të Rregullores së Kuvendit;



- planifikimit sistematik të veprimtarisë kontrolluese nga çdo komision i përhershëm parlamentar sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, duke përgatitur një kalendar kontrolli/monitorimi;

- organizimit periodik nga komisionet e përhershme parlamentare të seancave dëgjimore me ministrat dhe zyrtarë të tjerë të lartë të qeverisë, me qëllim marrjen e informacioneve dhe të shpjegimeve për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre.

2. Ngritja e komisioneve hetimore në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

## **II.b. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit dhe forcimi i bashkëpunimit dhe monitorimit mbi institucionet e pavarura**

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon 10 masa, të cilat synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura, me qëllim garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre.

1. Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit Europian për vitin 2014 për institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj përmes organizimit të seancave dëgjimore me titullarët e këtyre institucioneve, si dhe përfshirjes së vlerësimit të progresit në zbatimin e rekomandimeve të raportit të progresit për vitin 2014 në rezolutat që Kuvendi miraton mbi veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura.

2. Shqyrtimi nga Kuvendi i raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat dhe afatet ligjore të raportimit në Kuvend që parashikohen në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit (neni 103) dhe ligjet organike që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

3. Zbatimi edhe nga komisionet e tjera parlamentare të praktikës së krijuar tashmë nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për marrjen e mendimit edhe nga aktorë të shoqërisë civile dhe grupet e interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit në Kuvend të veprimtarisë së institucioneve të pavarura.

4. Ndjekja sistematike nga Kuvendi të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga institucionet e pavarura (KLSH-ja, Avokati i Popullit etj.) për institucionet e tjera shtetërore, pasqyrimi i tyre (sipas vlerësimit rast pas rasti) në projektligjet që shqyrtohen nga komisionet e përhershme parlamentare.

5. Shkëmbimi i vazhdueshëm dhe më i shpeshtë i informacioneve ndërmjet Kuvendit dhe institucioneve të pavarura, me qëllim që Kuvendi të informohet lidhur me problematikat që shoqërojnë funksionimin e tyre, si dhe të marrë masa për zgjidhjen e tyre.

6. Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi i strukturës së ERE-s, pasi ajo të depozitohet në Kuvend nga ky institucion.

7. Zbatimi i vendimit të Kuvendit nr. 64/2013, datë 26.11.2013 “Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së”, i ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 71/2014.

8. Plotësimi i vendeve vakante që krijohen në institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, duke respektuar afatet dhe procedurat që parashikohen në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit (neni 111) dhe ligjet përkatëse organike lidhur me zgjedhjen/emërimin nga Kuvendi të titullarëve dhe të anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura.

9. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe plotësimi i vendeve vakante të krijuara në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (4 vende vakante, duke përfshirë edhe guvernatorin e Bankës së Shqipërisë), si dhe në pozicionin e inspektorese së përgjithshme të Bankës së Shqipërisë.

10. Plotësimi i vendeve vakante të krijuara në këto institucione të pavarura:

- në bordin drejtues të AMF-së (2 vende vakante, kryetari dhe një anëtar i AMF-së);
- në bordin e ERE-s (4 vende vakante);
- në KDRTSH (11 vende vakante, përfshirë edhe kryetarin e KDRTSH-së);



- në AMA (1 vend vakant);
- në KQZ (3 vende vakante).

## **II.c. Forcimi i rolit kontrollues të Kuvendit në çështjet e integritit evropian**

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon 7 masa, të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të rolit kontrollues të Kuvendit dhe në veçanti të Komisionit për Integrimin Evropian mbi veprimtarinë e qeverisë në kuadër të procesit të integritit Evropian të Shqipërisë. Konkretisht:

1. Analizë mbi efektet që mund të sjellë rishikimi i ligjit nr. 9252, datë 8.07.2004, “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në rolin mbikëqyrës të Kuvendit dhe në veçanti të Komisionit për Integrimin Evropian mbi veprimtarinë e qeverisë në procesin e integritit evropian.

2. Mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit Shqipëri-BE përmes përdorimit më sistematik dhe intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe të rekomanduara nga Komisioni Evropian në vitin 2013 (miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.05.2014).

4. Mbikëqyrja e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014–2020 (miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 2.07.2014).

5. Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2014 për Shqipërinë.

6. Shqyrtimi i raportit të Ministrisë së Integritit Evropian për ecurinë e financimeve nga BE-ja në kuadër të programeve IPA të paktën 1 herë në vit.

7. Shqyrtimi në mënyrë periodike i raporteve që Ministria e Integritit Evropian i dërgon në mënyrë periodike Komisionit Evropian lidhur me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.

## **OBJEKTIVI III: forcimi i transparencës së Kuvendit**

Forcimi i transparencës dhe i ndërveprimit të Kuvendit me shoqërinë civile dhe publikun, bazuar në parimin e reflektimit të perspektivës qytetare gjatë zhvillimit të çdo veprimtarie parlamentare, do të jetë një nga prioritetet e punës së Kuvendit gjatë vitit 2015. Masat e parashikuara në këtë pjesë të Planit të Veprimit synojnë rritjen e perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe rritjen e perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotësisht i hapur dhe transparent, që ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit.

1. Publikimi në kohë i akteve të prodhuara nga komisionet parlamentare.

2. Rishikimi i Rregullores së Kuvendit, neni 39, pika 2, me qëllim përshtatjen e saj me standardet më të larta të transparencës në veprimtarinë e komisioneve parlamentare.

3. Organizmi më i shpeshtë i seancave dëgjimore publike me grupet e interesit për projektligjet apo çështje të zbatimit të ligjeve, si dhe organizimi i mbledhjeve të përbashkëta të komisioneve për shqyrtimin e projektligjeve apo të çështjeve të caktuara, duke i parashikuar ato në programin e punës dhe në kalendarin e punimeve të komisioneve të përhershme të Kuvendit.

4. Hartimi dhe vënia në zbatim nga Kuvendi i programit të transparencës sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe zbatimi i manualit për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit.

5. Caktimi i një nëpunësi nga stafi administrativ i Kuvendit si koordinator për të drejtën e informimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.



6. Projektimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në fushën e informatizimit dhe të automatizimit në Kuvend.

7. Implementimi i një sistemi *Case Management* për dixhitalizimin e proceseve të ndryshme administrative në Kuvendin e Shqipërisë.

8. Përmbyllja e fazës së parë zbatuese të platformës *e-parliament*.

9. Faqe e re interneti dhe intraneti për Kuvendin e Shqipërisë në përputhje me standardet perëndimore dhe rekomandimet e projektit *IPA* (2013).

10. Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Komunikimit të Kuvendit.

11. Zhvillimi i aktiviteteve profesionale për informimin e opinionit publik mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë, me synim përmirësimin e imazhit dhe të perceptimit publik për rolin e Kuvendit në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit, duke stimuluar pjesëmarrjen e nxënësve dhe të studentëve në veprimtaritë e hapura parlamentare.

12. Sigurimi i një baze të plotë të dhënash për kërkimin parlamentar për plotësimin në kohë dhe me kualitet të kërkesave të përdoruesve, gjithashtu dhe për përgjigjen në kohë e me cilësi të kërkesave të ECPRD-së, si tregues i një shërbimi cilësor dhe efikas.

13. Hapja e 24 zyrave për deputetët e Kuvendit në 12 qarqet e vendit.

#### **OBJEKTIVI IV: forcimi i autonomisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit**

Autonomia financiare e parlamentit është e domosdoshme në një vend demokratik dhe një nga parakushtet për një ndarje efektive të pushteteve, sipas nenit 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup>.

1. Analizë e kuadrit kushtetues dhe ligjor ekzistues (ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”) lidhur me buxhetin e shtetit.

2. Hartim i një ligji të veçantë për buxhetin e Kuvendit, i cili duhet të parashikojë procedurat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Kuvendit në mënyrë të pavarur nga qeveria.

3. Rishikimi i Rregullores së Kuvendit, me qëllim përshtatjen e saj me ndryshimet që mund të sjellë rishikimi i kuadrit kushtetues dhe ligjor ekzistues lidhur me autonominë buxhetore të Kuvendit.

#### **OBJEKTIVI V: forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit**

Gjatë vitit 2015 Kuvendi i Shqipërisë do t’i kushtojë vëmendje të veçantë zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integritit evropian.

##### **V.a. Forcimi i burimeve njerëzore**

Masat që parashikon kjo pjesë e Planit të Veprimit synojnë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe ekspertizës së Kuvendit përmes përmirësimit të menaxhimit të brendshëm, trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, si dhe akordimit të fondeve të mjaftueshme financiare për trajnimin e stafit të Kuvendit.

1. Ndryshim në strukturën e Shërbimit të Burimeve Njerëzore të Kuvendit, duke krijuar një strukturë që do të mbulojë koordinimin me donatorët dhe hartimin e projekteve të Kuvendit.

2. Parashikimi i një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës së Kuvendit.

3. Hartimi dhe miratimi i planit të trajnimit të stafit të Kuvendit për vitin 2015.

4. Trajnimi i vazhdueshëm i shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme.

5. Ndryshim në strukturën e administratës së Kuvendit duke shtuar: këshilltar jurist



(Shërbimi Juridik), këshilltar jurist (Njësia e Përafrimit të Legjislacionit) dhe dy specialistë IT (Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit).

6. Miratimi i rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit”.

#### **V.b. Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit në çështjet e integritit europian**

Kjo pjesë e Planit të Veprimit parashikon 5 masa konkrete (trajnime të specializuara në çështjet e BE-së, vizita studimore etj.), të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe të ekspertizës së strukturave administrative të Kuvendit që mbulojnë çështjet e integritit europian, me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre në fusha specifike të politikave dhe të legjislacionit të BE-së.

1. Rishikimi i formatit të analizës së përputhshmërisë me *acquis* të BE-së të projektligjeve që i propozohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e tij me ndryshimet që mund të sjellë rishikimi i ligjit nr. 9252, datë 8.07.2004.

2. Trajnim (vizitë studimore) mbi rolin e Kuvendit në procesin e negociatave të aderimit në BE (shkëmbim përvoje me Kroacinë dhe shtete të tjera anëtare të BE-së, sipas mundësive).

3. Seminar me stafet administrative të parlamenteve të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të Parlamentit Europian mbi sfidat e anëtarësimit (fusha specifike të *acquis*)

4. Vizitë studimore në një shtet anëtar të BE-së lidhur me organizimin e procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së.

5. Përgatitja e një analize mbi strukturat aktuale të Kuvendit dhe rolin e tyre në të ardhmen në procesin e integritit.

---

<sup>4</sup>Një nga gjetjet e projektit IPA “*Forcimi i Kuvendit të Shqipërisë*” (2013) është se Kuvendi nuk ka autonomi buxhetore nga qeveria, çka bie në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

